



STANDARTI EITI

Sekretariati Ndërkombëtar EITI 11 korrik 2013

Standarti EITI

© EITI 2013

Edituar nga Sam Bartlett dhe

Dyveke Rogan

Dizenjuar nga Alison Beanland

Ky publikim (përfshijë logon) mund

të riprodhohet pa pagesë në çdo lloj formati apo mjete

me kusht që të riprodhohet në mënyrë të saktë

dhe të mos përdoret në një kontekst të gabuar.

E drejta e autorit për këtë material i përket EITI-t

duke specifikuar titullin dhe burimin e publikimit.

EITI gjithashtu gëzon të drejtën e autorit

për rregullimin tipografik dhe dizajnin.

Printuar në Norvegji, 2013

Sekretariati Ndërkombëtar EITI

Ruseløkkveien 26

0251 Oslo

Norvegji

Tel: +47 222 00 800

Website: www.eiti.org

E-mail: secretariat@eiti.org

Përmbajtje

Parathënie	6
Hyrje	8
PJESA I: Zbatimi i Standardit EITI.....	9
1 Parimet EITI	9
2 Kërkesat për vendet zbatuese të nismës EITI	12
3 Udhëzuesi i Vlerësimit (Validimit)	35
4 Protokoll: Pjesëmarrja e shoqërisë civile	40
PJESA II: Qeverisja dhe drejtimi	43
5 Statuti i Organizatës.....	44
6 Politika e EITI-t për transparence.....	53
7 Projekt-Udhëzimet e Përfaqësimit të EITI-t	54

Parathënie

EITI ka evoluar gjatë dhjetë viteve që nga Konferenca e parë e tij në vitin 2003, ku u miratuan Parimet EITI. Këto Parime, mbi të cilat ai mbështetet, theksojnë se të gjithë qytetarët duhet të përfitojnë nga pasuria që rrjedh nga burimet natyrore të një vendi dhe se kjo kërkon standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies. Pas miratimit të Parimeve, u hartuan rregullat që garantojnë angazhimin e të gjitha vendeve anëtare të EITI-t për një nivel minimal transparence në raportimet e kompanive lidhur me pagesat e kryera ndaj shtetit dhe raportimet e qeverisë për këto pagesa.

Gjatë këtyre dhjetë viteve të para është arritur shumë, dhe mbështetur në këtë përvojë, të gjithë grupet e interesit janë të vetëdijshëm se është koha të zhvillojmë Standartin tonë në mënyrë që të përmbushim më mirë objektivat që i vendosëm vetes në kohën kur u miratuan Parimet EITI. Ajo që ka më shumë rëndësi është fakti që ne duhet të kalojmë nga një proces që inkurajon plotësimin e kërkesave tona tek një proces që inkurajon menaxhim më të mirë të sektorit nxjerrës në secilin prej vendeve anëtare.

Bordi i EITI-t dhe partnerët tanë janë konsultuar dhe kanë punuar së bashku për një periudhë dy vjeçare me qëllim përmirësimin e standartit EITI. Si rezultat i kësaj pune kemi një standart që nxit më shumë informacion të besueshëm, të përshtatshëm dhe të përdorshëm, si dhe lidhje më të mirë me reforma më të gjera. Gjithashtu, është e rëndësishme që ne të vendosim një standart minimal i cili nuk është shumë i vështirë për t'u arritur nga vende që përballen me sfida madhore në drejtim të reformave, por, në të njëjtën kohë, nxit edhe përmirësimin e vazhdueshëm pavarësisht pikënisjes.

Standarti i ri ruan ende shumicën e kërkesave të Rregullores ekzistuese të EITI-t, por është ristrukturuar në mënyrë të ndjeshme në një grup më të vogël kërkesash me pritshmëri më të qarta. Domosdoshmëria e nxitjes së zotërimit kombëtar të përpjekjeve për reforma nga ana e EITI-t me qëllim që t'i shërbejë sa më mirë interesave të qytetarëve të vendeve anëtare ka qenë një parim i rëndësishëm që ka udhëhequr këto përmirësime. Kërkesat për plane pune kombëtare të nismës EITI janë hartuar për të siguruar përfshirje më të madhe të raportimit EITI në prioritetet dhe reformat kombëtare. Me qëllim që Raportet EITI të jenë më të lehtë për t'u kuptuar dhe përdorur, po paraqesim një kërkesë të re që ka të bëjë me përfshirjen në raporte të informacioneve kontekstuale bazë rreth regjimit fiskal, kuadrin kontraktual, prodhimit, procedurave të licensimit, alokimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Shpresojmë që kjo përmbledhje të jetë e lexueshme për qytetarët e interesuar dhe të ndihmojë në nxitjen e një debati kombëtar më të informuar.

Ne kemi forcuar kushtet për raportimin EITI në përpjekje për të siguruar që të dhënat në Raportin e EITI të ofrojnë një panoramë të plotë të të ardhurave të grumbulluara. Në disa raste ka qenë e vështirë të vërtetohet besueshmëria e të dhënave. Një përmirësim të dukshëm në lidhje me këtë aspekt përbën rënia dakord që të gjitha Raportet EITI të pasqyrojnë pagesat nga secila

kompani në vend të të dhënave të agreguara. Me dispozitat e reja që lidhen me ndërmarrjet shtetërore dhe procedurat për garantimin e besueshmërisë së shifrave, Raportet EITI do të përmbajnë deklarime më të mira dhe më të sakta të pagesave dhe të ardhurave. Së fundi, sistemi i Validimit, i cili vlerëson nëse vendet e kanë zbatuar EITI-n në përputhje me kërkesat tona, është thjeshtuar tashmë duke u dhënë mundësi vendeve zbatuese të dedikojnë më shumë kohë dhe burime për të përmirësuar menaxhimin e sektorit.

Në Konferencën Globale EITI të vitit 2009 në Doha, EITI u themelua si person juridik, ndërsa Organizata e Anëtarëve EITI u krijua me miratimin e statutit të Organizatës. Eksperiencia ka treguar se Statuti i Organizatës ka funksionuar mirë, dhe janë nevojitur vetëm ndryshime të vogla.

Ashtu si në çdo organizatë që kërkon të arrijë objektiva të vështira, edhe kërkesat për zbatimin e EITI-t kanë evoluar me kalimin e kohës dhe pa dyshim do të jenë subjekt përpunimi të mëtejshëm në të ardhmen. EITI duhet të zhvillohej, duke pasur parasysh dhe ato që kemi mësuar në kuadrin e zhvillimeve të tjera të rëndësishme dhe të nismave komplementare që kërkojnë transparence të përmirësuar në menaxhimin e burimeve natyrore. Sfidat kryesore që kemi përpara na japin mundësi që ne të njohim dhe të mësojmë nga vendet që tejkalojnë kërkesat minimale dhe krijojnë stimuj për përdorim inovativ të EITI-t në interes të vendeve të tij zbatuese.

Si Kryetare e EITI-t, është një privilegj të drejtosh punën shpesh komplekse, por gjithmonë të vlefshme në këtë proces me shumë grupe interesi. Të gjithë partnerët kanë punuar shumë për të arritur kompromise që mbështesin zhvillimin e një EITI më efektiv. Unë jam jashtëzakonisht mirënjohëse për të gjithë personat e përfshirë. I vetëm, EITI, nuk mund të garantojë që të gjithë qytetarët të jenë përfitues të pasurisë nga burimet natyrore; kjo kërkon përpjekje më të gjerë për reforma. Megjithatë, transparenca që nxitet nga EITI mund të ndihmojë në realizimin e reformave. Duhet ende shumë kohë që qytetarët e vendeve të pasura me burime natyrore të shohin përfitime reale. Unë shpresoj dhe besoj se Standarti i ri EITI do të kontribuojë ndjeshëm për realizimin e këtij objektivi dhe do të na çojë më tej drejt përmbushjes së aspiratave të përcaktuara në Parimet EITI.

Londër, 2 Maj 2013

Clare Short, Kryetare e Bordit të EITI-t.

Hyrje

Standarti EITI përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë *Zbatimi i Standardit EITI*; dhe pjesa e dytë *Qeverisja dhe menaxhimi*.

Pëmbledhja në faqen 10 ofron një **pasqyrë të asaj që pritet nga vendet zbatuese të EITI-t**.


Pjesa e parë “Zbatimi i Standardit EITI” përfshin: **Parimet EITI**, të cilat u miratuan nga të gjitha grupet e interesit në vitin 2003. Këto Parime përcaktojnë qëllimet dhe angazhimet e përgjithshme të të gjitha grupeve të interesit.

Kërkesat EITI që duhet të respektohen nga vendet zbatuese të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse. Kërkesat përfshijnë dhe bashkojnë dispozitat që gjendeshin më parë tek Kriteret, Kërkesat dhe Politikat në Rregulloren e EITI-t, të vitit 2011.

Udhëzuesi i Vlerësimit, i cili ofron udhëzime për Vlerësuesit e EITI-t dhe vendet zbatuese. Ai u miratua fillimisht në vitin 2006 dhe është përmirësuar ndjeshëm që prej miratimit.

Protokolli “Pjesëmarrja e shoqërisë civile”, i miratuar nga Bordi i EITI-t më 16 shkurt 2011.

Pjesa e dytë “Qeverisja dhe menaxhimi” përmban një hyrje të shkurtër mbi mënyrën e organizimit të EITI-t. Kjo pasohet nga Statuti i Organizatës, së bashku me dispozitat për mënyrën e drejtimit të Organizatës së Vendeve Anëtare të EITI-t. Në 2013, Bordi i EITI-t miratoi Politikën për Transparencë, e cila gjendet pas Statutit. Ai përfshin Projekt-Udhëzimet e Konstituencës (Përfaqësimit) të EITI-t.



PJESA I

1 Parimet e EITI-t

Një numër i madh vendesh, kompanish dhe organizatash të ndryshme të shoqërisë civile morën pjesë në konferencën e “Lancaster House”, që u organizua në Londër (2003), nën kujdesin e Qeverisë së Britanisë së Madhe. Pjesëmarrësit miratuan Deklaratën e Parimeve që synon të rrisë transparencën lidhur me pagesat dhe të ardhurat në sektorin e industrisë nxjerrëse. Të njohura si Parimet e EITI-t, ato përfaqësojnë gurin e themelit të kësaj nisme.

Parimet e EITI-t

1 Ne ndajmë të njëjtën bindje se shfrytëzimi me maturi i pasurive të burimeve natyrore duhet të përbëjë një motor të rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike që kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm dhe uljen e varfërisë, por që, pa një menaxhim të mirë, mund të ketë impakte të padëshiruara në planin ekonomik dhe social.

2 Ne afirmojmë se menaxhimi i pasurive të burimeve natyrore në dobi të qytetarëve të një vendi është kompetencë e qeverive sovrane, e cila ushtrohet në interes të zhvillimit të tyre kombëtar.

3 Ne konstatojmë se avantazhet e nxjerrjes së burimeve shfaqen në formën e fluksit të të ardhurave përgjatë një periudhe relativisht të gjatë kohore dhe mund të varen shumë nga çmimi.

4 Ne konstatojmë se mirëkuptimi nga ana e publikut për të ardhurat dhe shpenzimet e qeverive në kohë, ka gjasa të kontribuojë në debatin publik dhe ta bëjë më të lehtë zgjedhjen e opsioneve të duhura dhe realiste që favorizojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

5 Ne nënvizojmë rëndësinë e transparencës, si dhe nevojën për përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe respektimin e detyrimit për llogaridhënie nga ana e qeverive dhe shoqërive të industrive nxjerrëse.

6 Ne konstatojmë se është e nevojshme që t’i përqendrojmë forcat për arritjen e një transparence më të madhe në një kontekst të respektimit të kontratave dhe të ligjeve.

7 Ne konstatojmë se transparenca financiare është një mjet që ka gjasa të kontribuojë për përmirësimin e klimës për investime të drejtëpërdrejta të brendshme dhe të jashtme.

8 Ne besojmë në parimin dhe praktikën e përgjegjësisë së qeverisë përpara të gjithë qytetarëve përsa i përket administrimit të fluksit të të ardhurave dhe shpenzimeve publike.

9 Ne jemi të angazhuar të inkurajojmë respektimin e standardeve të larta të transparencës dhe të përgjegjshmërisë në jetën publike, funksionimin e shtetit dhe botën e biznesit.

10 Ne besojmë në domosdoshmërinë e një qëndrimi koherent dhe realist ndaj publikimit të pagesave dhe të të ardhurave, qëndrim ky që duhet të jetë i thjeshtë për t'u ndërmarrë dhe për t'u zbatuar.

11 Ne jemi të mendimit se publikimi i pagesave në një vend të caktuar duhet të përfshijë të gjitha shoqëritë e industrive nxjerrëse të pranishme në atë vend.

12 Kur bëhet fjalë për gjetjen e zgjidhjeve, ne vlerësojmë se të gjitha palët e interesuara - qeveritë dhe agjencitë e tyre, shoqëritë e industrive nxjerrëse, shoqëritë e shërbimit, organizatat shumëpalëshe, organizatat financiare, investitorët dhe organizatat joqeveritare – duhet të japin një kontribut përkatës të rëndësishëm.

2 Kërkesat për vendet zbatuese të EITI

Si ta lexojmë këtë kapitull

Ky kapitull përcakton kërkesat që duhet të respektohen nga vendet zbatuese të EITI-t. Ekzistojnë dy grupe të vendeve zbatuese: Vend Kandidat dhe Vend Anëtar. Statusi i vendit kandidat është një gjendje e përkohshme i cili synon ta drejtojë vendin drejt përputhshmërisë, në kohën e duhur, me Standartin EITI. Në mënyrë që të bëhen kandidatë të EITI-t, vendet duhet të tregojnë se kanë plotësuar kërkesat nga 1.1-1.4 përmes procesit të përshkruar më poshtë. Dispozitat e detajuara që duhet të plotësohen përpara aplikimit për Vend Kandidat në EITI janë paraqitur në faqet 12-15. Për t'u bërë vende anëtar EITI, vendet zbatuese duhet të demonstrojnë përmes Validimit (Vlerësimit) se i kanë përmbushur Kërkesat 1-7 të EITI-t. Kërkesat janë dhënë në mënyrë të përmbledhur në kutinë 1. Kërkesat e EITI-t janë kërkesa minimale dhe vendet zbatuese inkurajohen t'i kapërcejnë ato në rastet kur grupet e interesit mendojnë se kjo gjë është e përshtatshme. Grupet e interesit mund të konsultojnë materiale udhëzuese shtesë për të garantuar përmbushjen e kërkesave, të cilat janë të disponueshme në www.eiti.org.

Kutia 1 Kërkesat e EITI-t

EITI kërkon:

- 1 Mbikqyrje efikase nga grupet e ndryshme të interesit.
- 2 Publikimin në kohë të Raporteve EITI.
- 3 Përfshirje të informacioneve kontekstuale për industrinë nxjerrëse në Raportet e EITI-t.
- 4 Përgatitjen e Raporteve të plota përfshirë publikimin e të gjitha të ardhurave me rëndësi materiale që qeveritë marrin nga kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse si dhe

publikimin e të gjitha pagesave me rëndësi materiale që kompanitë u bëjnë qeverive lidhur me shfrytëzimin e naftës, të gazit dhe mineraleve.

5 Zhvillimin e një procesi të besueshëm garantimi përmes aplikimit të standardeve ndërkombëtare.

6 Raportet e EITI-t duhet të jenë të kuptueshëm, të promovohen në mënyrë aktive, të jenë lehtësisht të aksesueshëm nga publiku dhe të kontribuojnë në debatin publik.

7 Ndërmarrjen e hapave nga grupi ndër-institucional i punës për të vepruar mbi bazën e mësimave të nxjerra dhe analizimin e rezultateve dhe ndikimeve nga zbatimi i EITI-t.

Secila prej këtyre kërkesave është paraqitur në mënyrë të plotë në këtë kapitull.

Hyrja në EITI

Një vend që synon të zbatojë nismën EITI duhet të ndërmarrë një sërë hapash përpara aplikimit për vend kandidat. Këto hapa janë dhënë në mënyrë të përmbledhur në kutinë 2.

Kutia 2 Hapat për anëtarësim:

1.1 Qeveria duhet të bëjë një deklaratë të qartë publike lidhur me qëllimin e saj për zbatimin e EITI-t.

1.2 Qeveria duhet të emërojë një person me pozitë të lartë për të drejtuar zbatimin e EITI-t.

1.3 Nevojitet angazhimi i qeverisë për të punuar me shoqërinë civile dhe kompanitë me qëllim krijimin e grupit ndër-institucional të punës për të mbikëqyrur zbatimin e EITI-t.

1.4 Grupi ndër-institucional i punës duhet të mbajë një plan pune të përditësuar, tërësisht të kostuar (që përfshin kostot) dhe të përafuar me afatet e raportimit dhe Validimit (vlerësimit) të përcaktuara nga Bordi i EITI-t.

Pasi vendi i ka përmbushur këto hapa dhe dëshiron të pranohet si vend kandidat në EITI, qeveria e atij vendi duhet t'i dorëzojë Bordit të EITI-t Aplikimin për vend kandidat (shih kutinë 3).

Kutia 3 Aplikimi për vend kandidat në EITI

Pasi vendi ka plotësuar hapat për anëtarësim dhe dëshiron të pranohet si vend kandidat, Qeveria, me mbështetjen e grupeve të ndryshme të interesit, dorëzon Kërkesën për vend kandidat në EITI, duke përdorur formularin e parashikuar për Aplikim¹. Aplikimi duhet të përshkruajë aktivitetet e ndërmarra deri në atë moment dhe të ofrojë të dhëna që dëshmojnë plotësimin e secilit prej hapave për anëtarësim.

Aplikimi duhet të përmbajë detajet e kontaktit për qeverinë, shoqërinë civile dhe grupet e interesit nga sektori privat që janë të përfshirë në nismën EITI. Bordi i EITI-t merr në shqyrtim kërkesën dhe vlerëson nëse hapat për anëtarësim janë plotësuar siç duhet.

Sekretariati Ndërkombëtar merr kontakte me grupet kombëtare të interesit për t'u

njohur me pikëpamjet e tyre mbi procesin e anëtarësimit, dhe kërkon komente nga qeveritë mbështetëse, grupet ndërkombëtare të shoqërisë civile, kompanitë dhe organizatat mbështetëse, si dhe investitorët. Sekretariati Ndërkombëtar punon ngushtë me drejtuesin e emëruar nga qeveria për të udhëhequr zbatimin e nismës me qëllim qartësimin e të gjitha çështjeve që janë ende të pazgjidhura. Mbështetur tek kjo dhe informacione të tjera të disponueshme, Personi i kontaktit pranë Bordit të EITI-t dhe Komiteti i Kandidaturave i dorëzojnë Bordit të EITI-t, brenda një periudhe kohore të arsyeshme, rekomandimin në lidhje me pranimin apo mos-pranimin e kërkesës së një vendi. Më pas, Bordi i EITI-t do të marrë vendimin përfundimtar.

Bordi parapëlqen t'i marrë vendimet për pranimin apo mos-pranimin e një vendi kandidat në EITI gjatë mbledhjeve të tij. Në rast se koha midis dy mbledhjeve është shumë e gjatë, atëherë Bordi i EITI-t mund të vendosë për marrjen e vendimit përmes qarkores së Bordit. Pas pranimin si vend kandidat, Bordi përcakton gjithashtu afatet për publikimin e Raportit të parë EITI dhe kryerjen e procesit të Validimit. Raporti i parë i një vendi zbatues publikohet brenda 18 muajve nga data e pranimin si vend kandidat në EITI. Vendet candidate duhet të fillojnë Validimin brenda dy viteve e gjysëm nga data e pranimin si vend kandidat. Kërkesa 1.6 më poshtë ofron informacion më të zgjeruar mbi politikën e afateve.

1. Disponohet prej Sekretariatit Ndërkombëtar.

Kërkesa EITI 1

Nisma EITI kërkon mbikqyrje efikase nga grupi ndër-institucional.

Vështrim i Përgjithshëm – Nisma EITI kërkon mbikqyrje efikase nga grupi ndër-institucional i punës që përfshin qeverinë, kompanitë si dhe pjesëmarrjen e plotë, të pavarur, aktive dhe efikase të shoqërisë civile. Elementët kryesorë të kësaj kërkesë janë: (1.1) angazhimi i qeverisë; (1.2) mbikqyrja qeveritare; (1.3) krijimi i një grupi ndër-institucional; dhe (1.4) miratimin e një plani pune me objektiva të qarta për zbatimin e nismës EITI, dhe afatet kohore të përafuara me ato të përcaktuara nga Bordi i EITI-t (1.6-1.8).

1.1 Qeveria duhet të bëjë një deklaratë të qartë publike lidhur me qëllimin e saj për zbatimin e nismës për transparencë.

Deklarata duhet të bëhet nga kreu i shtetit apo qeverisë, apo nga një përfaqësues të deleguar nga qeveria.

1.2 Qeveria duhet të emërojë një person me pozitë të lartë për të drejtuar zbatimin e EITI.

Personi i emëruar në këtë funksion duhet të gëzojë besimin e të gjitha palëve të interesuara, autoritetin dhe lirinë për të koordinuar veprimtarinë e EITI-t me ministritë dhe agjencitë përkatëse, si dhe duhet të jetë në gjendje të mobilizojë burimet për implementimin e tij.

1.3 Nevojitet angazhimi i qeverisë për të punuar me shoqërinë civile dhe kompanitë me qëllim krijimin e një grupi ndër-institucional për të mbikëqyrur zbatimin e EITI-t.

a) Qeveria, kompanitë dhe shoqëria civile duhet të angazhohen në mënyrë të plotë, aktive dhe efektive në këtë proces EITI.

b) Qeveria duhet të garantojë krijimin e një klime të përshtatshme që favorizon pjesëmarrjen e kompanive dhe shoqërisë civile në përputhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative përkatëse si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI-t. Duhet të respektohen të drejtat themelore të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe kompanive të cilët janë angazhuar realisht në nismën EITI, duke përfshirë, por jo vetëm, anëtarët e grupeve të interesit.

c) Qeveria duhet të lehtësojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe kompanive në procesin e EITI-t.

d) Qeveria duhet të shmangë veprimet që rezultojnë në ngushtimin ose kufizimin e debatit publik në lidhje me zbatimin e nismës.

e) Palët e interesuara, duke përfshirë, anëtarët e grupeve të ndryshme të interesit, por jo vetëm, duhet:

i. Të jenë në gjendje të flasin lirshëm për çështje që kanë lidhje me transparencën dhe administrimin e burimeve natyrore.

ii. Të angazhohen thellësisht në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI, dhe të sigurohen që ajo të kontribuojë në debatin publik.

iii. Kanë të drejtë të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

iv. Të jenë në gjendje të veprojnë lirisht dhe të shprehin opinionet rreth EITI-t pa rezerva, detyrim apo frikë nga ndërshkimi.

f) Gjatë krijimit të grupit ndër-institucional, qeveria duhet:

i. Të sigurojë që ftesa për të marrë pjesë në grup të jetë e hapur dhe transparente.

ii. Të sigurojë përfaqësim adekuat të palëve të interesuara. Kjo nuk do të thotë që ata duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë nga pikëpamja numerike. Grupet e interesit duhet të përfshijnë palët e duhura të interesuara, përfshirë, por jo domosdoshmërisht vetëm: sektorin privat; shoqërinë civile, grupet e pavarura të shoqërisë civile si mediat dhe sindikatat; si dhe subjekte të rëndësishme qeveritare ku mund të përfshihen edhe deputetë. Secila nga palët e interesuara duhet të ketë të drejtë të caktojë përfaqësuesit e vet, duke pasur parasysh dëshirën për përfaqësim pluralist dhe të larmishëm. Proçesi i emërimit duhet të jetë i pavarur dhe i lirë nga çdo sugjerim imponues. Grupet e shoqërisë civile të përfshira në EITI si anëtarë të grupit të punës duhet të jenë të pavarur nga qeveria dhe/ose kompanitë në aspektin e veprimtarisë dhe politikave të tyre.

iii. Të garantojë përfaqësimin e zyrtarëve të lartë të qeverisë në grupin ndër-institucional të punës.

iv. Të marrë parasysh krijimin e bazës ligjore për këtë grup.

g) Grupi i punës duhet të miratojë Termat e Referencës (TeR) për punën e vet të cilat duhet të jenë të qarta për publikun. Termat e Referencës duhet të përmbajnë minimalisht dispozitat për: **Rolin, përgjegjësitë dhe të drejtat e grupit ndër-institucional:**

i. Anëtarët e grupit të punës duhet të jenë në gjendje të realizojnë detyrat e tyre.

ii. Grupi duhet të ndërmarrë, së bashku me grupet e shoqërisë civile dhe kompanitë, aktivitete informuese efikase, nëpërmjet komunikimit në media, faqe interneti dhe letra, për t'i informuar aktorët mbi angazhimin e qeverisë në zbatimin e EITI-t dhe rolin qendror të kompanive dhe shoqërisë civile në këtë proçes. Gjithashtu, grupi i punës duhet të realizojë shpërndarjen e gjerë të informacionit publik që rrjedh si rezultat i proçesit EITI siç është Raporti i EITI-t.

iii. Anëtarët e grupit ndër-institucional të punës duhet të mbajnë lidhje me grupet që i kanë zgjedhur.

Miratimi i planeve të punës, Raporteve të EITI dhe raporteve vjetore të aktivitetit:

iv. Grupi ndër-institucional duhet të kryejë miratimin e planeve vjetore të punës, emërimin e Administratorit të Pavarur, Termat e Referencës për Administratorin e Pavarur, Raportet e EITI dhe raportet vjetore të aktivitetit.

v. Grupi i punës duhet të mbikqyrë procesin e raportimit dhe duhet të angazhohet në procesin e Validimit (Vlerësimit) në përputhje me kapitullin 3.

Rregullat dhe procedurat për qeverisje të brendshme:

vi. EITI kërkon një vendim-marrje gjithëpërfshirëse gjatë gjithë zbatimit të nismës, duke i trajtuar si partnerë të gjithë personat përfaqësues. Çdo anëtar i grupit të punës ka të drejtë të shtrojë çështje për diskutim. Grupi duhet të miratojë procedurat e emërimit dhe ndryshimit të përfaqësuesve të palëve të interesuara, procedurat e vendim-marrjes, kohëzgjatjen e mandatit dhe numrin e mbledhjeve që duhet të mbahen. Është e nevojshme të garantohet që procesi për ndryshimin e anëtarëve të grupit të respektojë parimet e përcaktuara në Kërkesën 1.3 (f).

vii. Njoftimet për mbledhje bëhen në avancë për t'i dhënë kohë të mjaftueshme grupit të qarkullojë në kohë dokumentet, përpara diskutimit dhe miratimit të propozuar të tyre.

viii. Grupi ndër-institucional mban shënime rreth diskutimeve dhe vendimeve të tij.

1.4 Grupi i punës duhet të mbajë një plan pune të përditësuar, tërësisht të kostuar (që përfshin kostot) dhe të përfruar me afatet e raportimit dhe Validimit (vlerësimit) të përcaktuara nga Bordi i EITI-t.

Plani i punës duhet:

a) të përcaktojë objektivat e zbatimit të EITI-t që janë të lidhura me Parimet EITI dhe reflektojnë prioritetet kombëtare për industrinë nxjerrëse. Grupi i punës inkurajohet të kërkojë qasje të reja për zgjerimin e zbatimit të EITI-t për të rritur gjithëpërfshirjen e raportimit EITI dhe njohuritë e publikut mbi të ardhurat si dhe për të nxitur standarte të larta lidhur me transparencën dhe detyrimin për llogaridhënie në jetën publike, funksionimin e shtetit dhe botën e biznesit.

b) të reflektojë rezultatet e konsultimeve me grupet kryesore të interesit, dhe të miratohet nga grupi ndër-institucional.

c) Të përfshijë aktivitete të matshme dhe me afate të përcaktuara për të arritur objektivat e pranuar. Fusha e zbatimit të nismës duhet të përshtatet në mënyrë që të kontribuojë në objektivat e dëshiruara të cilat janë identifikuar gjatë procesit të konsultimit.

Plani i punës duhet:

i. Të vlerësojë dhe të përshkruajë planet për trajtimin e kufizimeve të mundshme në kapacitete të agjencive qeveritare, kompanive dhe shoqërisë civile që mund të përbëjnë pengesë për zbatimin efektiv të EITI-t.

ii. Të adresojë fushën e raportimit të EITI-t, përfshirë planet për adresimin e aspekteve teknike të raportimit, të tilla si gjithëpërfshirja dhe besueshmëria e të dhënave (Kërkesat 4 dhe 5).

iii. Të identifikojë dhe përshkruajë planet për të trajtuar barrierat e mundshme ligjore ose rregullatore për zbatimin e EITI-t, përfshirë, nëse është e mundur, çdo plan për përfshirjen e Kërkesave të EITI-t në legjislacionin ose rregullat kombëtare.

d) Të identifikojë burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit dhe asistencës teknike, kur kjo gjë është e përshtatshme, për të siguruar zbatimin në kohë të planit të punës të miratuar.

e) Të jetë gjerësisht i disponueshëm për publikun, për shembull nëpërmjet publikimit në faqen kombëtare të internetit të EITI-t dhe/ose faqet e internetit të ministrive dhe agjencive të tjera përkatëse, në median e shkruar apo në vende që janë lehtësisht të aksesueshme për publikun.

f) Të rishikohet dhe përditësohet çdo vit. Gjatë rishikimit të planit të punës, grupi ndër-institucional duhet të shqyrtojë mundësinë e thellimit të nivelit të detajimit dhe qëllimin e raportimit EITI duke përfshirë trajtimin e çështjeve të tilla si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (3.7-3.8), pagesat e transportit (4.1.f), shpenzimet sociale diskrecionale (4.1.e), transfertat rajonale (jo në nivel kombëtar) për këtë qëllim (ad-hoc) (4.2.e) pronësinë e dobishme (3.11) dhe kontratat (3.12). Në përputhje me Kërkesën 1.3 (g) (viii), grupi ndër-institucional i punës ka si detyrim të dokumentojë diskutimet dhe vendimet e tij.

g) Të vendosë një afat kohor për zbatim që është në linjë me afatet e raportimit dhe Validimit të përcaktuara nga Bordi i EITI-t (shih 1.6), dhe që merr parasysh kërkesa të tilla administrative si proceset e prokurimit dhe të financimit.

1.5 Zbatimi i përshtatur

Në rast se grupi i punës gjykon se po përballet me rrethana të jashtëzakonshme që nxisin nevojën për devijim nga kërkesat e zbatimit, ai duhet të kërkojë miratimin paraprak të Bordit të EITI-t për zbatim të përshtatur. Kërkesa duhet të miratohet nga grupi ndër-institucional dhe të pasqyrohet në planin e punës. Kërkesa duhet të shpjegojë arsyet për zbatim të përshtatur. Bordi i EITI-t vendos rreth lejimit të përshtatjeve (ndryshimeve) vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Gjatë shqyrtimit të kërkesave të tilla, Bordi i jep përparësi domosdoshmërisë për trajtim të krahasueshëm midis vendeve si dhe ruajtjes së Parimeve të EITI-t, zbatimit të një procesi mjaft gjithëpërfshirës, dhe përgatitjes së Raportit EITI i cili duhet të jetë i plotë, i besueshëm dhe të kontribuojë në debatin publik.

1.6 Afatet e raportimit dhe të Validimit EITI

a) Afatet e raportimit EITI

EITI kërkon publikimin në kohë të raporteve (Kërkesa 2). Nëse një vend nuk publikon Raportin EITI brenda afatit të përcaktuar, ai pezullohet. Bordi i EITI-t heq pezullimin në rast se Raporti i prapambetur publikohet jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i afatit. Nëse raportet e prapambetura nuk publikohen brenda gjashtë muajve nga afati përfundimtar, pezullimi mbetet në fuqi derisa Bordi të konstatojë se vendi ka publikuar një Raport EITI që përmban të dhëna që i përkasin harkut kohor midis periudhës së dytë të plotë kontabël dhe periudhës së fundit të plotë kontabël (Kërkesa 2). Nëse pezullimi lihet në fuqi për më shumë se një vit, Bordi i EITI-t revokon statusin e vendit kandidat.

b) Afatet e Validimit të EITI-t

Vendet zbatuese duhet të kryejnë Validim të rregullt për të përcaktuar nëse zbatimi pajtohet me Standartin EITI (shih kapitullin 3).

Afatet e Validimit janë ilustruar në figurën 1.



Vendet candidate të EITI-t, duhet të fillojnë Validimin (Vlerësimin) brenda dy viteve e gjysëm nga data e pranimit si vend kandidat. Validitimi përcakton nëse vendi është: (1) në përputhje me nismën; (2) nuk është në përputhje me nismën, por ka bërë progres thelbësor; ose (3) nuk është në përputhje me EITI, dhe nuk ka bërë progres thelbësor (shih më poshtë). Një vend mund të mbajë statusin e vendit kandidat në EITI për jo më shumë se pesë vjet nga data e pranimit si i

tillë. Në rast se një vend nuk arrin të sigurojë statusin e vendit anëtar brenda tre viteve e gjysmë nga marrja e statusit të vendit kandidat, vendi konsiderohet vend kandidat (i pezulluar) i EITI-t deri në marrjen e veprimeve përfundimtare korrigjuese.

Pajtueshmëria me EITI: Në rastet kur raporti i Validimit tregon se vendi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Bordit EITI, ai bëhet vend anëtar përmes miratimit të Bordit. Për të ruajtur statusin e vendit anëtar në EITI, vendet anëtare duhet të vazhdojnë të respektojnë Parimet dhe Kërkesat e tij. Vendet anëtare duhet të kryejnë procesin e Validimit çdo tre vjet.

Në rastin kur një vend është bërë anëtar i EITI-t, por ekzistojnë shqetësime të ngritura në lidhje me rënien më pas të nivelit të zbatimit të tij nën standartin e kërkuar, Bordi i EITI-t ruan të drejtën t'i kërkojë atij vendi që t'i nënshtrohet një procesi të ri Validimi apo Inspektimi nga ana e Sekretariatit. Palët e interesuara, Grupi Nderinstitucional I Punes, mund t'i paraqesin një peticion Bordit të EITI-t në qoftë se ata gjykojnë se duhet të rishikohet statusi i vendit anëtar. Kjo kërkesë mund të ndërmjetësohet nëpërmjet përfaqësuesit (përfaqësuesve) të grupit të punës në Bordin e EITI-t. Bordi EITI, shqyrton situatën dhe ushtron lirinë e tij për të kërkuar një Validim të parakohshëm apo Inspektim nga ana e Sekretariatit. Statusi i vendit përcaktohet bazuar në gjetjet e vlerësimit.

Bordi i EITI-t gëzon të drejtën që të ndryshojë statusin e vendit nga ish-anëtar në kandidat, duke specifikuar edhe veprimet korrigjuese, ose të pezullojë apo revokojë statusin e tij. Kur një vend anëtar nuk ka arritur nivelin e pajtueshmërisë por ka bërë progres të dukshëm ose nuk ka bërë progres të dukshëm gjatë Validimit pasardhës, aplikohen procedurat e përcaktuara më poshtë.

Progres domethënës: Në mënyrë që Bordi të arrijë në përfundimin se vendi ka bërë progres domethënës, duhet që Validimi apo Inspektimi nga ana e Sekretariatit të tregojnë se vendi ka bërë më në fund progres domethënës duke i përmbushur të shtatë Kërkesat e EITI-t. Gjatë vlerësimit të progresit domethënës, Bordi merr parasysh:

(1) Procesin e EITI-t, në veçanti funksionimin e grupit të punës dhe angazhimin e qartë e të fortë të qeverisë.

(2) Gjendjen dhe cilësinë e raportimit EITI, përfshirë progresin thelbësor në përmbushjen e kërkesave për raportim në kohë, sipas kërkesës 2 dhe, kur është e zbatueshme, përpjekjet për trajtimin e rekomandimeve për përmirësimin e zbatimit të nismës.

2. Koha që i duhet një vendi për t'iu nënshtuar Validimit nuk konsiderohet pjesë e periudhës maksimale të statusit të vendit kandidat.

Nëse nga Validitimi i parë rezulton se një vend kandidat ka bërë progres domethënës drejt arritjes së pajtueshmërisë, por nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat, vendi do të ruajë statusin e vendit kandidat për një periudhë shtesë prej dymbëdhjetë muajsh. Bordi i EITI-t përcakton masat korrigjuese që vendi duhet të ndërmarrë gjatë kësaj periudhe për të arritur pajtueshmërinë me të. Pajtueshmëria do të vlerësohet përmes një Validimi të dytë. Në rastet kur veprimet korrigjuese të nevojshme për arritjen e pajtueshmërisë mund të vlerësohen shpejt dhe në mënyrë objektive, Bordi i EITI-t mund të shqyrtojë mundësinë e autorizimit të Inspektimit nga ana e Sekretariatit si një alternativë për një Validim të dytë.

Bordi i EITI-t mund të pezullojë vendin nëse nga Validitimi i dytë ose Inspektimi nga ana e Sekretariatit rezulton se vendi ka bërë progres domethënës, por nuk ka arritur pajtueshmërinë me standartin EITI. Bordi i EITI-t përcakton veprimet korrigjuese që vendi duhet të ndërmarrë për të arritur pajtueshmërinë. Pezullimi hiqet atëherë kur Inspektimi nga ana e Sekretariatit tregon se janë përmbushur veprimet korrigjuese dhe Bordi i EITI-t është i kënaqur me përmbushjen e kërkesave të prapambetura. Nëse pezullimi qëndron në fuqi për më shumë se dymbëdhjetë muaj, Bordi i EITI-t ruan të drejtën e përjashtimit të vendit nga organizata. Sipas Kërkesës 1.7 (a), Bordi mund të vendosë zgjatjen e pezullimit për gjashtë muaj të tjerë shtesë, pra për një periudhë maksimale pesë-vjeçare të statusit kandidat, në qoftë se ka patur progres të vazhdueshëm dhe masat korrigjuese të papërmbushura janë minimale dhe mund të realizohen shpejt.

Nuk ka përparim domethënës: Nëse Bordi konkludon se as përfundimet e Validitimit dhe as ato të Inspektimit nga Sekretariati nuk tregojnë se vendi ka bërë të paktën progres domethënës në përmbushjen e të gjitha Kërkesave EITI, vendit përjashtohet nga nisma EITI.

c) Raportet vjetore të punës

MSG (grupi ndër-institucional i punës) duhet të publikojë raporte vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar (Kërkesa 7.2). Raporti mbi aktivitetet e vitit të mëparshëm duhet të publikohet brenda 1 Korrikut të vitit pasardhës. Bordi i EITI-t vendos afate të përshtatshme për vendet e reja kandidate. Nëse raporti vjetor i punës nuk publikohet brenda gjashtë muajve nga kjo datë, dmth deri më 31 Dhjetor, Bordi i EITI-t ndërmerr pezullimin e vendit derisa të bindet se raporti i vonuar është publikuar.

d) Shtyrja e Afateve

Një vend zbatues mund të kërkojë zgjatje të afatit në rast se nuk ka mundësi të përmbushë ndonjë prej afateve të specifikuar në seksionet (a), (b) dhe (c) më sipër. Bordi i EITI-t aplikon testet e mëposhtme për të vlerësuar kërkesat për zgjatje afati:

1. Kërkesa duhet të bëhet para përfundimit të afatit dhe të miratohet nga MSG.

2. MSG duhet të demonstrojë se ka bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së afatit por është vonuar për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme. Gjatë vlerësimit të progresit domethënës, Bordi i EITI-t merr parasysh:

(i) Proçesin e EITI-t, në veçanti funksionimin e MSG-së (grupit ndër-institucional të punës) dhe angazhimin e qartë e të fortë të qeverisë.

(ii) Gjendja dhe cilësia e raportimit EITI, përfshirë progresin thelbësor në përmbushjen e kërkesave për raportim në kohë, sipas kërkesës 2 dhe, kur është e zbatueshme, përpjekjet për trajtimin e rekomandimeve për përmirësimin e zbatimit të EITI-t.

3 Kërkesa e paraqitur nga MSG duhet të përmbajë shpjegim të rrethanës apo rrethanave të jashtëzakonshme.

4 Nuk do të jepet asnjë zgjatje afati që mund të rrisë periudhën maksimale të statusit kandidat.

1.7 Pezullimi

a) Pezullim për shkak të shkeljeve të Parimeve dhe Kërkesave EITI.

Bordi i EITI-t ndërmerr pezullimin apo përjashtimin e një vendi kur është haptazi e qartë se një aspekt i rëndësishëm i Parimeve dhe Kërkesave EITI nuk është respektuar. Në përputhje me Kërkesën 1.6, kjo përfshin rastet kur vendi nuk ka plotësuar kërkesat për raportim në kohë, publikim të raporteve vjetore të punës dhe/ose për të arritur përputhshmërinë me Kërkesat EITI sipas afateve të përcaktuara nga Bordi i EITI-t. Në rastet kur Bordi konstaton me shqetësim se është komprometuar respektimi i Parimeve dhe Kërkesave, ai mund të ngarkojë Sekretariatit Ndërkombëtar të mbledhë informacion në lidhje me situatën dhe dorëzimin e raportit në Bord.

Pezullimi i një vendi zbatues është një mekanizëm i përkohshëm. Bordi i EITI-t cakton një afat kohor prej dymbëdhjetë muajsh për vendet zbatuese me qëllim zgjidhjen e çështjes së shkeljeve ndaj Standardit EITI. Nëse çështja nuk zgjidhet në mënyrë të kënaqshme brenda afatit të përcaktuar nga Bordi, atëherë ai vendos revokimin e statusit të vendit. Nëse raporti i dytë i Validimit, i cili realizohet pas vendimit për pezullim, nuk tregon arritje të pajtueshmërisë, Bordi i EITI-t mund të vendosë zgjatjen e pezullimit për gjashtë muaj të tjerë shtesë, pra deri në përfundimin e periudhës maksimale pesë vjeçare të statusit kandidat. Bordi i EITI-t mund të zgjasë afatin e pezullimit vetëm në rastet kur ka pasur progres të vazhdueshëm dhe masat korrigjuese të papërmbushura janë minimale dhe mund të realizohen shpejt.

b) Pezullim për shkak të paqëndrueshmërisë apo konfliktit politik.

Bordi i EITI-t mund të vendosë pezullimin e atyre vendeve ku mungesa e stabilitetit apo konflikti politik krijon pengesa të dukshme në respektimin e disa aspekteve të rëndësishme të Parimeve dhe Kërkesave EITI. Vendet që janë duke përjetuar destabilitet apo konflikt të jashtëzakonshëm politik mund të kërkojnë pezullim vullnetar nga EITI. Në një situatë të tillë,

qeveria duhet të depozitojë një kërkesë në Bordin e EITI-t për pezullim vullnetar. Kërkesa e qeverisë duhet të evidentojë opinionet e MSG-së.

Në rast pezullimi për shkak të paqëndrueshmërisë apo konfliktit politik, periodha e pezullimit nuk do të llogaritet si pjesë e periudhës maksimale të statusit kandidat. Bordi i EITI-t monitoron dhe inspekton rregullisht situatën në vend.

c) Heqja e pezullimit

Qeveria mund të aplikojë në çdo kohë për heqjen e pezullimit. Kërkesa duhet të dokumentojë hapat e miratuara nga MSG për ri-fillimin e procesit të zbatimit të EITI-t dhe Validimit, si dhe planin e punës për arritjen e përputhshmërisë. Bordi vendos heqjen e pezullimit atëherë kur ai bindet se arsyet për pezullim janë adresuar siç duhet. Pas heqjes së pezullimit, Bordi vendos sipas rastit afate të reja për raportim dhe Validim. Është e domosdoshme që shqetësimet dhe vendimet e Bordit në lidhje me vendin zbatues të komunikohen në mënyrë të qartë në të gjitha fazat e procesit.

Vendet e pezulluara do të konsiderohen vend kandidat (i pezulluar) ose vend anëtar (i pezulluar) i EITI-t gjatë gjithë periudhës që zgjat pezullimi, ndërsa statusi i tyre do të publikohet në faqen e internetit të EITI-t dhe kudo gjetkë.

1.8 Përjashtimi

Përjashtimi, pra revokimi i statusit të vendit si vend zbatues i EITI-t ndodh kur:

(1) Në përputhje me Kërkesën 1.7 (a), vendi zbatues ka qenë objekt pezullimi, dhe çështja nuk është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme sipas afatit të miratuar nga Bordi i EITI-t.

(2) Në përputhje me Kërkesën 1.6(b), Bordi i EITI-t arrin në përfundimin se vendi nuk ka bërë përparim domethënës në zbatimin e nismës.

Në rastet kur duket qartazi se një aspekt i rëndësishëm i Parimeve dhe Kërkesave EITI nuk është respektuar nga një vend zbatues, Bordi ruan të drejtën e përjashtimit të vendit nga organizata. Pas përjashtimit, një vend mund të aplikojë për ri-pranim si vend kandidat në çdo kohë. Bordi zbaton procedurat e aprovuara në lidhje me vlerësimin e kërkesave për vend kandidat. Ai gjithashtu vlerëson përvojën e mëparshme në zbatimin e EITI-t, duke marrë parasysh edhe barrierat e mëparshme që kanë penguar zbatimin efektiv të tij dhe të masave korrigjuese.

1.9 Ankimimi

Një vend zbatues i interesuar mund t'i kërkojë Bordit të EITI-t, pas përfundimit të Validimit, të rishikojë vendimin e tij në lidhje me pezullimin, përjashtimin ose përcaktimin e statusit të vendit

kandidat apo anëtar në EITI. Gjatë hartimit të përgjigjeve ndaj kërkesave të tilla, Bordi merr në konsideratë faktet, domosdoshmërinë e ruajtjes së integritetit të EITI-t dhe parimin e trajtimit të barabartë të vendeve. Vendimi i Bordit është përfundimtar. Vendi i interesuar mund të apelojë vendimin e Bordit në mbledhjen e ardhshme të anëtarëve, përpara periudhës së shpalljes së njoftimit sipas nenit 8 të Statutit të Organizatës.

Kërkesa EITI 2.

EITI kërkon publikimin në kohë të Raporteve EITI.

Vështrim i përgjithshëm – Raportet EITI janë më të dobishme dhe të rëndësishme kur publikohen në mënyrë të rregullt dhe përmbajnë të dhëna aktuale. Kërkesa 2 përcakton afatet kohore për raportim në kohë.

2.1 Vendet zbatuese duhet të përgatisin Raportin e tyre të parë EITI brenda 18 muajve nga data e pranimit si vend kandidat. Më pas, pritët që vendet zbatuese t'i përgatisin këto Raporte çdo vit.

2.2 Raportet duhet të përmbajnë të dhëna që i përkasin harkut kohor midis periudhës së dytë të plotë dhe periudhës së fundit të plotë kontabël p.sh. një Raport i publikuar në vitin kalendarik/financiar 2014 duhet të bazohet në të dhëna që i përkasin vitit kalendarik/financiar 2012. MSG inkurajohet të shqyrtojë mundësitë për publikim të raporteve EITI sa më parë që të jetë e mundur. Në rast se raportimi është vonuar ndjeshëm, MSG duhet të ndërmarrë masa për të siguruar që raportet EITI të botohen për periudhat raportuese të ndërmjetme në mënyrë që çdo vit të jetë i përfshirë në raportim.

2.3 MSG duhet të miratojë periudhën kontabël që do të mbulohet në Raport.

Kërkesa EITI 3

EITI kërkon që Raportet të përmbajnë informacione kontekstuale rreth industrive nxjerrëse.

Vështrim i përgjithshëm. Në mënyrë që Raportet EITI të jenë gjithëpërfshirëse dhe të dobishme për publikun, ato duhet të shoqërohen me informacione kontekstuale rreth industrisë nxjerrëse të cilat janë të disponueshme për publikun. Ky informacion duhet të përmbajë një përshkrim përmbledhës të kuadrit ligjor dhe regjimit fiskal (3.2); së bashku me një panoramë të industrive nxjerrëse (3.3); kontributin e industrisë nxjerrëse në planin ekonomik (3.4); të dhënat mbi prodhimin (3.5); pjesëmarrjen e shtetit në industrinë nxjerrëse (3.6); alokimin dhe qëndrueshmërinë e të ardhurave (3.7 -3.8), regjistrin dhe shpërndarjen e licensave (3.9- 3.10); si dhe të gjitha dispozitat e zbatueshme lidhur me pronësinë e dobishme (3.11) dhe kontratat (3.12). MSG duhet të emërojë personin përgjegjës për mbledhjen e informacionit kontekstual (3.1).

3.1 Hartimi i informacionit kontekstual:

MSG duhet të miratojë procedurat dhe përgjegjësitë për përgatitjen e informacionit kontekstual për Raportin EITI. Burimi i informacioni duhet të jetë i qartë.

3.2 Raporti duhet të përshkruajë kuadrin ligjor dhe regjimin fiskal që udheheq industrinë nxjerrëse.

a) Ky informacion duhet të përmbajë një përshkrim përmbledhës të regjimit fiskal, përfshirë nivelin e decentralizimit, një pasqyrë të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, si dhe informacion mbi rolet dhe përgjegjësitë e agjencive qeveritare përkatëse.

b) Në rast se qeveria është duke ndërmarrë reforma, atëherë MSG duhet të garantojë që ato të jenë të dokumentuara në Raport.

3.3 Raporti duhet të ofrojë një panoramë të industrisë nxjerrëse, përfshirë çdo aktivitet të rëndësishëm kërkimi.

3.4 Raporti duhet të bëjë publike, nëse është e mundur, informacione në lidhje me kontributin e industrive nxjerrëse në sektorin e ekonomisë për vitin fiskal të përfshirë në Raport.

Ky informacion pritet të përfshijë:

a) Madhësinë e industrisë nxjerrëse në terma absolute dhe si përqindje të PBB-së, së bashku me një vlerësim mbi aktivitetin e sektorit informal.

b) Të ardhurat totale të qeverisë të gjeneruara nga industrinë nxjerrëse (përfshirë taksat, rentat, bonuset, tarifatat dhe pagesa të tjera) në terma absolute dhe si përqindje të të ardhurave totale të qeverisë.

c) Eksportet nga industrinë nxjerrëse në terma absolute dhe si përqindje të totalit të eksporteve.

d) Punësimi në industrinë nxjerrëse në terma absolute dhe si përqindje e totalit të punësimit.

e) Rajonet/zonat kryesore e ku është përqëndruar prodhimi.

3.5 Raporti duhet të publikojë të dhëna mbi prodhimin për vitin fiskal që ai mbulon, si dhe:

a) Vëllimin total dhe vlerën e prodhimit sipas produktit, dhe nëse është e mundur, sipas shtetit/rajonit të origjinës.

b) vëllimin total dhe vlerën e eksporteve sipas produktit, dhe nëse është e mundur, sipas shtetit/rajonit të origjinës.

3.6 Kur nga pjesëmarrja e shtetit në industrinë nxjerrëse rezultojnë pagesa të të ardhurave materiale, Raporti EITI duhet të përfshijë:

a) Një shpjegim të rregullave dhe praktikave ekzistuese në lidhje me marrëdhënien financiare midis qeverisë dhe ndërmarrjeve shtetërore (NSH), p.sh. rregullat dhe praktikat që udhëheqin transfertat e fondeve midis NSH-ve dhe shtetit, fitimet e realizuara, ri-investimet dhe financimin nga palë të treta.

b) Publikimin e informacionit shpjegues të NSH-ve mbi shpenzimet e tyre gati-fiskale (quasi-fiscal) si pagesat për shërbimet sociale, infrastrukturën publike, subvencionet e karburantit dhe shërbimin e borxhit kombëtar. MSG duhet të zhvillojë një proces raportimi që synon arritjen e një niveli transparence të krahasueshëm me flukset e të ardhurave dhe pagesat e tjera, si dhe përfshirjen e filialeve të NSH-ve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta.

c) Publikimin e informacionit shpjegues nga qeveria dhe NSH-të mbi nivelin e pronësisë së dobishme në kompanitë minerare, të naftës dhe gazit që operojnë në sektorin vendas të minierave, naftës dhe gazit, përfshirë ato në zotërim të degëve të NSH-ve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta, si dhe ndryshimet në nivelin e pronësisë gjatë periudhës raportuese. Ky informacion duhet të përmbajë detaje lidhur me termat bashkëngjitur kapitalit aksioner, si dhe shkallën e përgjegjësisë së tyre për mbulimin e shpenzimeve në faza të ndryshme të ciklit të projektit, si për shembull, kapital i paguar plotësisht, kapital i lirë, fitime nga interesat. Në rast ndryshimesh në nivelin e pronësisë të qeverisë dhe NSH-ve gjatë periudhës raportuese, qeveria dhe NSH-të duhet të bëjnë publike kushtet e transaksionit, përfshirë detaje në lidhje me vlerësimin e të ardhurave. Në rast se qeveria dhe NSH-të kanë dhënë kredi apo garanci kredie për kompanitë minerare, të naftës dhe gazit që operojnë në vend, detajet mbi këto transaksione duhet të publikohen në Raportin EITI.

3.7 Raporti EITI duhet të përshkruajë shpërndarjen e të ardhurave nga industrinë nxjerrëse.

a) Raporti duhet të tregojë se të ardhurat e cilës industri, qoftë *cash* apo me natyrë të ngjashme, regjistrohen në buxhetin e shtetit. Duhet të ofrohet një shpjegim për shpërndarjen e të ardhurave që nuk janë regjistruar në buxhetin e shtetit, i shoqëruar sipas rastit me linqet e raporteve financiare përkatëse, p.sh. për pasurinë sovranë dhe fondet e zhvillimit, qeveritë lokale, ndërmarrjet shtetërore, dhe subjekte të tjera jo-buxhetore.

b) MSG-të inkurajohen t'u referohen sistemeve kombëtare të klasifikimit të të ardhurave dhe standardeve ndërkombëtare të tilla si Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë dhe FMN-së.

3.8 MSG-ja inkurajohet të përfshijë informacion shtesë rreth menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në Raportin EITI, së bashku me:

a) Një përshkrim të të ardhurave nga industria nxjerrëse të dedikuara për rajone specifike gjeografike. Ai duhet të përshkruajë metodat që garantojnë përgjegjshmëri dhe efikasitet në përdorimin e tyre.

b) Një përshkrim të buxhetit të shtetit dhe proceseve të auditimit si dhe linqet për informacione mbi buxhetin, shpenzimet dhe raportet e auditimit të cilat janë të disponueshme për publikun.

c) Të dhëna në kohën e duhur nga ana e qeverisë të cilat rrisin më tej informimin e publikut dhe nxisin debate rreth çështjeve të qëndrueshmërisë së të ardhurave dhe varësisë nga burimet. Kjo mund të përfshijë supozime të cilat do të shërbejnë si bazë për vitet e ardhshme në ciklin buxhetor dhe që lidhen me prodhimin e projektuar, çmimet e mallrave dhe parashikimet e të ardhurave të gjeneruara nga industritë nxjerrëse si dhe përqindjen e të ardhurave të ardhshme fiskale që pritet të vijnë nga sektori nxjerrës.

3.9 Regjistri i licensave

a) Termi “licensë” në këtë kontekst i referohet çdo license, kontratë qiraje, titulli, leje apo koncesioni përmes së cilës qeveria i jep të drejta kompanive apo individëve për kërkim apo shfrytëzim të naftës, gazit dhe/ose burimeve minerare.

b) Vendet zbatuese duhet të mbajnë një regjistër publik ose sistem(e) kadastral të pajisur me informacion të duhur dhe të plotë në lidhje me secilën nga licensat në zotërim nga kompanitë e përfshira në Raportin EITI:

i. Zotëruesi i licensës (s).

ii. Koordinatat e zonës së licensës.

iii. Data e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatja (vlefshmëria) e licensës.

iv. Në rastin e licensave të prodhimit, artikullin e prodhuar.

Duhet që regjistri i licensave ose kadastra të përfshijnë informacion që ka të bëjë me licensat që zotërojnë të gjitha subjektet, përfshirë kompanitë dhe individët ose grupet që nuk janë objekt i Raportit EITI, pasi pagesat e tyre janë nën prapësinë e miratuar të materialitetit. Barrierat e rëndësishme ligjore ose praktike që pengojnë këtë publikim gjithëpërfshirës duhet të dokumentohen dhe shpjegohen në Raport, së bashku me një përshkrim të planeve të qeverisë lidhur me përpjekjet për të kapërcyer këto barrierat dhe afatet e parashikuara për arritjen e tyre.

c) Në rast se informacioni i paraqitur në 3.9 (b) është aktualisht në dispozicion të publikut, atëherë ai duhet të përfshihet si referencë apo link në Raportin EITI. Në rast se regjistri apo kadastra nuk ekziston apo ka mangësi, Raporti i duhet të bëjë të njohura të gjitha boshllëqet e krijuara në informacionin publik dhe duhet të dokumentojë përpjekjet e mundshme për forcimin e këtyre sistemeve. Ndërkohë që vetë Raporti duhet të përfshijë informacionin e përcaktuar më sipër në 3.9 (b).

3.10 Alokimi i licensave

a) Vendet zbatuese duhet të bëjnë të njohur informacionin lidhur me akordimin apo transferimin e licensave që zotërohen nga kompanitë e përfshira në Raport, së bashku me: një përshkrim të procesit për transferimin ose akordimin e licencës; kriteret teknike dhe financiare të përdorura; informacion lidhur me marrësin(t) e licensës që është transferuar apo akorduar dhe, sipas rastit, anëtarët e konsorciumit; dhe të gjitha devijimet e rëndësishme nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që udhëheq transferimin dhe akordimin e licensave.

b) Qeveria duhet të publikojë listën e aplikantëve dhe kriteret për tenderim në rast se licencat janë akorduar përmes procesit të tenderimit gjatë periudhës kontabël të përfshirë në raport.

c) Në rastin kur informacioni i përcaktuar në 3.10 (a) dhe 3.10 (b) më sipër është aktualisht në dispozicion të publikut, mjafton që ai të jetë i përfshirë në raport referencë apo link.

d) MSG mund të përfshijë në raport informacion shtesë për shpërndarjen e licensave, si dhe komentet mbi efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre sistemeve.

3.11 Pronësia e dobishme

a) Është e këshillueshme që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër publik të kompanive përfituese që konkurrojnë, operojnë ose investojnë në pasuritë nxjerrëse, përfshirë identitetin e pronarit apo pronarëve përfitues dhe nivelin e pronësisë. Nëse ky informacion është bërë tashmë publik për shembull përmes dokumenteve të dorëzuara tek rregullatorët dhe bursat, atëherë Raporti EITI duhet të përmbajë udhëzime për mënyrën e aksesit tek ky informacion.

b) Në rast se regjistri apo kadastra nuk ekziston apo ka mangësi, rekomandohet që vendet zbatuese t'u kërkojnë kompanive që marrin pjesë në process të sigurojnë informacionin e nevojshëm për Raportin EITI³.

3. (Në takimin e 22-të të Bordit të EITI-t, u ra dakord që EITI të kërkojë bërjen publike të pronësisë së dobishme në të ardhmen. Bordi i EITI-t do të hartojë dispozita të detajuara me qëllim që ta kthejë këtë në një kërkesë duke nisur nga 1 Janari 2016, pas një procesi pilot të suksesshëm.)

c) Është e nevojshme që qeveria dhe/ose ndërmarrjet shtetërore të bëjnë publike nivelin e pronësisë së dobishme të kompanive minerare, të naftës dhe gazit që operojnë në vend, si dhe çdo ndryshim në nivelin e pronësisë gjatë periudhës kontabël që mbulohet në Raport (Kërkesa 3.6 (c)).

d) Përkufizimi i pronësisë të dobishme:

i. Një pronar përfitues në kontekstin e një shoqërie, nënkupton personin apo personat fizik që zotërojnë apo kontrollojnë në mënyrë direkte apo indirekte një entitet.

ii. Gjatë trajtimit të pronësisë së dobishme, MSG duhet të miratojë një përkufizim të përshatshëm për termin pronar përfitues. Përkufizimi duhet të jetë në linjë me kërkesën 3.11 (d), (i) më sipër dhe duhet të marrë në konsideratë normat ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare përkatëse.

iii. Kompanitë e regjistruara publikisht, përfshirë filialet në pronësi të plotë të tyre, nuk janë të detyruara të publikojnë informacione për pronarin apo pronarët e tyre.

iv. Në rastin e sipërmarrjeve të përbashkëta, secili nga subjektet që është pjesë e sipërmarrjes duhet të publikojë informacion lidhur me pronarin apo pronarët e tij, me përjashtim të rasteve kur ai është regjistruar publikisht apo është filial në pronësi të plotë sipas 3.11 (d) (iii). Secili prej entiteteve është përgjegjës për saktësinë e informacionit të ofruar.

3.12 Kontratat

a) Vendet zbatuese inkurajohen të bëjnë publike të gjitha kontratat dhe licensat që përmbajnë kushtet për shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve.

b) Kjo është një kërkesë që tregon sesi Raporti EITI dokumenton politikën e qeverisë në lidhje me bërjen publike të kontratave dhe licensave, e cila kontrollon eksplorimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Ajo duhet të përfshijë dispozitat ligjore përkatëse, praktikat aktuale për publikimin e informacioneve si dhe reformat e planifikuara apo ato në proces. Nëse është e mundur, Raporti duhet të ofrojë një panoramë të kontratave dhe licensave që janë të disponueshme për publikun si dhe të përfshijë një referencë apo link të faqes ku ato janë publikuar.

c) Termi “kontratë” në 3.12(a) do të thotë:

i. Tekstin e plotë të çdo kontrate, koncesioni, marrëveshje me ndarje prodhimi apo kontrata të tjera të akorduara apo nënshkruara nga qeveria, e cila përmban kushtet për shfrytëzim të naftës, gazit dhe burimeve minerare.

ii. Tekstin e plotë të çdo aneksi apo shtojce që përcakton detajet lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 3.12(c)(i) apo zbatimin e tyre.

iii. Tekstin e plotë të çdo ndryshimi apo amendimi në dokumentet e përmendura në 3.12(c)(i) dhe 3.12(c)(ii).

d) Termi “license” në 3.12(a) do të thotë:

i. Tekstin e plotë të çdo license, kontratë qiraje, titulli apo leje përmes së cilës qeveria i akordon kompanive apo individëve të drejta lidhur me kërkimin apo shfrytëzimin e naftës, gazit dhe/ose burimeve minerare.

ii. Tekstin e plotë të çdo aneksi ose amendimi që përcakton detajet perkatëse që kanë të bëjnë me të drejtat e eksplorimit të përshkruara në 3.12 (d)(i) ose të nxjerrjes; dhe

iii. Tekstin e plotë të çdo aneksi apo shtojce që përcakton detajet lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 3.12(d)(i) dhe 3.12(d)(ii).

Kërkesa EITI 4

EITI kërkon përgatitjen e Raporteve të plota dhe gjithëpërfshirëse që përfshijnë publikimin e të gjitha të ardhurave me rëndësi materiale që qeveritë marrin nga kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse si dhe publikimin e të gjitha pagesave me rëndësi materiale që kompanitë u bëjnë qeverive lidhur me shfrytëzimin e naftës, të gazit dhe mineraleve.

Vështrim i përgjithshëm – Të kuptuarit e pagesave të shoqërive dhe të ardhurave të qeverisë mund të stimulojë një debat publik më të informuar për administrimin e industrive nxjerrëse. EITI kërkon një rakordim të plotë midis pagesave të kompanive dhe të ardhurave të qeverisë nga industrinë nxjerrëse. Kërkesa 4 përcakton hapat që grupi ndër-institucional duhet të shqyrtojë në mënyrë që Raporti të ofrojë një përshkrim të plotë të këtyre pagesave dhe të ardhurave. Seksioni 4.1 përcakton kërkesat lidhur me llojet e pagesave dhe të ardhurave që do të përfshihen në Raport. Seksioni 4.2 specifikon kompanitë dhe subjektet qeveritare, si dhe ndërmarrjet shtetërore, që janë objekt raportimi.

4.1 Përcaktimi i taksave dhe të ardhurave që duhet të përfshihen në Raportin EITI

a) MSG bie dakord, përpara procesit të raportimit, se cilat pagesa dhe të ardhura kanë rëndësi materiale dhe për këtë arsye duhet të bëhen publike, duke përfshirë përcaktimin e duhur dhe

pragun e materialitetit. Pagesat dhe të ardhurat konsiderohen me rëndësi materiale nëse mos-përfshirja apo keq-deklarimi i tyre mund të ndikojë dukshëm në tërësinë e Raportit EITI. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim të flukseve të të ardhurave, përcaktimin dhe pragun e materialitetit. Gjatë përcaktimit të materialitetit, grupi i punës duhet të marrë në konsideratë madhësinë e fluksit të të ardhurave në raport me të ardhurat totale. Grupi i punës duhet të dokumentojnë opsionet e marra në shqyrtim si dhe arsyetimin llogjik për përcaktimin e bërë.

b) Duhet të përfshihen zërat e mëposhtëm të të ardhurave:

- i. E drejta e qeverisë pritëse mbi prodhimin (si fitimi i naftës).
- ii. E drejta e ndërmarrjeve shtetërore mbi prodhimin kombëtar.
- iii. Fitimet nga taksat.
- iv. Rentat minerare.
- v. Dividentët.
- vi. Bonuset, përfshirë bonuset e nënshkrimit, zbulimit dhe prodhimit.
- vii. Tarifat e licensave, qirasë, hyrjes dhe pagesa të tjera për licensa dhe/ose koncesione.
- viii. Pagesa të tjera të rëndësishme dhe përfitime materiale bërë tek shteti.

Zërat e të ardhurave ose përfitimet duhet të përjashtohen vetëm në raste kur ato nuk janë të zbatueshme, ose kur grupi i punës bie dakord se mos-përfshirja e tyre nuk ndikon në mënyrë thelbësore në tërësinë e Raportit EITI.

c) **Të ardhurat nga shitja e prodhimit shtetëror ose të ardhura me natyrë të ngjashme:** Në rastet kur të ardhurat nga shitja e pjesës shtetërore të prodhimit apo të ardhurat e tjera me natyrë të ngjashme janë të rëndësishme, qeveria, përfshirë ndërmarrjet shtetërore, duhet të bëjnë publike vëllimet e shitura dhe të ardhurat e siguruar. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen në nivele të krahasueshme me pagesa dhe të ardhura të tjera të raportuara (Kërkesa 5.2.e). Pagesat e publikuara mund të ndahen sipas llojit të produktit, çmimit, tregut dhe vëllimit të shitjes. Në rastet kur është konkretisht e mundur, grupi i punës ngarkon Administratorin e Pavarur për kuadrumin e vëllimeve të shitura dhe të ardhurave të marra duke përfshirë në procesin e raportimit edhe kompanitë blerëse.

d) **Sigurimi i infrastrukturës dhe marrëveshjet barter:** Grupi i punës dhe Administratori i Pavarur duhet të marrin në konsideratë faktin nëse ka apo jo marrëveshje, apo grupe marrëveshjes që përfshijnë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve (kredi, grante dhe punime në infrastrukturë), në këmbim të plotë ose të pjesshëm të aktivitetit për kërkim naftë, gazë apo mineralesh, koncesioneve të prodhimit ose transportit fizik të këtyre produkteve. Për ta bërë këtë, grupi ndër-institucional i punës dhe Administratori i Pavarur duhet të kuptojnë plotësisht: kushtet e marrëveshjes dhe kontratat përkatëse, palët e përfshira, burimet e ofruara nga shteti, vlera e zërit balancues (p.sh. punime infrastrukturore), dhe rëndësia e këtyre marrëveshjeve në raport me

kontratat e zakonshme. Në rastin kur grupi i punës arrin në përfundimin se këto marrëveshje janë materiale, atëherë nevojitet që grupi i punës dhe Administratori i Pavarur të sigurojnë trajtimin e këtyre marrëveshjeve në Raportin EITI, duke ofruar një nivel detajimi dhe transparence të barabartë me publikimin dhe rakordimin e pagesave dhe zërave të tjerë të të ardhurave. Në rast se rakordimi i transaksioneve kryesore nuk është i mundur, grupi i punës duhet të bjerë dakord për adoptimin e një qasje të re që përfshin deklarimin e njëanshëm të palëve në marrëveshjet që janë pjesë e Raportit EITI.

e) **Shpenzimet sociale:** Nëse shpenzimet sociale materiale të kompanive janë të sanksionuara me ligj apo nga kontrata me qeverinë e cila rregullon investimin përkatës nxjerrës, atëherë këto sanksione dhe rakordimi i tyre, në rast se është i mundur, duhet të publikohen në Raportin EITI.

i. Është e nevojshme që Raporti të deklarojë natyrën dhe vlerën e llogaritur të të ardhurave nga transaksione me natyrë të ngjashme. Kur përfituesi i shpenzimeve sociale të detyrueshme është një palë e tretë, pra jo një agjenci qeveritare, kërkohet të bëhet i ditur emri dhe funksioni i përfituesit.

ii. Në rast se rakordimi është i përealizueshëm, Raporti duhet të përfshijë deklaratat e njëanshme të kompanive apo qeverisë lidhur me transaksione të tilla.

iii. Nëse grupi i punës vlerëson se shpenzimet sociale diskrecionale dhe transfertat kanë rëndësi materiale, ai duhet të inkurajohet të zhvillojë një proces raportimi që synon arritjen e një niveli të barabartë transparence me deklarimin e pagesave dhe të ardhurave të tjera të entiteteve qeveritare. Në rastin kur rakordimi i transaksioneve kryesore është i pamundur, për shkak se pagesat e kompanive mund të jenë të një natyre të ngjashme apo të kryera ndaj një pale të tretë jo-qeveritare, grupi i punës mund të pranojë përfshirjen në Raport të deklaratave të njëanshme vullnetare të kompanive dhe/ose qeverisë.

f) **Transporti:** Qeveria dhe ndërmarrjet shtetërore duhet të deklarojnë të ardhurat e marra nga transporti i naftës, gazit dhe mineraleve kur këto përbëjnë zërat më të mëdha të të ardhurave në sektorin nxjerrës. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen në nivel të barabartë me të zërat e të ardhurave dhe pagesave të tjera të raportuara (Kërkesa 5.2.e). Raporti EITI mund të përmbajë:

i. Një përshkrim të marrëveshjeve të transportit, përfshirë: produktin, itinerarin e transportit; kompanitë përkatëse dhe subjektet qeveritare, së bashku me NSH-të e përfshira në transport.

ii. Përcaktimet e taksave, tarifave ose pagesave të tjera të rëndësishme të transportit, si dhe metodologjitë e përdorura për llogaritjen e tyre.

iii. Publikimin e tarifave dhe vëllimit të mallrave të transportuar.

iv. Deklarimin e të ardhurave të marra nga subjektet qeveritare, NSH-të, lidhur me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve.

v. Grupi i punës inkurajohet, kur kjo gjë është e mundur, të ngarkojë Administratorin e Pavarur me detyrën e rakordimit të pagesave dhe të të ardhurave materiale që lidhen me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve.

4.2 Përzgjedhja e kompanive dhe subjekteve qeveritare që janë të detyruara të raportojnë

a) Raporti EITI duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë midis të ardhurave të qeverisë dhe pagesave të kompanive, duke përfshirë pagesat ndaj dhe nga ndërmarrjet shtetërore, në përputhje me qëllimin e rënë dakord (Kërkesa 4.1). Të gjitha kompanitë që kryejnë pagesa materiale për qeverinë duhet t'i deklarojnë ato plotësisht në pajtim me objektin e raportimit. Një subjekt ekonomik mund të përjashtohet nga raportimi vetëm në rast se vërtetohet që pagesat dhe të ardhurat e tij nuk kanë rëndësi materiale. Të gjitha subjektet qeveritare që marrin të ardhura materiale duhet t'i deklarojnë ato plotësisht në përputhje me objektin e raportimit.

b) Gjithashtu, në rastet kur ekzistojnë pengesa të rëndësishme praktike, qeveria duhet të japë, në tërësi, informacion mbi sasinë e të ardhurave totale të marra nga secili prej zërave të pranuar në objektin e Raportit EITI, përfshirë të ardhurat që ndodhen nën pragun e përcaktuar të materialitetit. Në rast se këto të dhëna nuk janë të disponueshme, Administratori i Pavarur mbledh të gjitha të dhënat dhe vlerësimet përkatëse nga burime të tjera në mënyrë që të sigurojë një vlerësim gjithëpërfshirës të të ardhurave totale të qeverisë.

c) Ndërmarrjet shtetërore (NSH): Grupi i punës duhet të sigurojë që procesi i raportimit të trajtojë gjerësisht rolin e NSH-ve, përfshirë pagesat materiale që kompanitë e naftës, gazit dhe minerare u bëjnë atyre, si dhe transfertat midis NSH-ve dhe agencive të tjera qeveritare.

d) Pagesat lokale: Është e nevojshme që grupi i punës të përcaktojë nëse pagesat direkte që kompanitë u kanë bërë njësive të qeverisjes lokale, të cilat janë brenda objektit të raportimit, kanë rëndësi materiale. Në rast se po, grupi i punës duhet të sigurojë që deklaratat dhe rakordimi i pagesave dhe faturave përkatëse të përfshihet në Raportin EITI.

e) Transfertat lokale: Grupi i punës duhet të garantojë përfshirjen në Raportin EITI të deklaratave të transfertave materiale ndërmjet njësive të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore që lidhen me të ardhurat e gjeneruara nga industritë nxjerrëse dhe që janë të sanksionuara nga kushtetuta, statuti apo mekanizma të tjerë për ndarjen e të ardhurave. Raporti EITI duhet të përfshijë formulën e përdorur, nëse ka, për ndarjen e të ardhurave si dhe çdo mospërputhje ndërmjet shumës së transfertës të llogaritur në përputhje me formulën përkatëse për ndarjen e të ardhurave dhe shumës aktuale të transferuar midis njësive të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Grupi ndër-institucional i punës duhet të kryejë kuadrin e këtyre transfertave. Grupi

inkurajohet të përfshijë në Raportin EITI deklaratat, dhe nëse është e mundur të bëjë kuadrimin, e transfertave diskrecionale apo ‘ad-hoc’ me rëndësi materiale. Në rast se ka pengesa kushtetuese reale apo domethënëse përsa i përket pjesëmarrjes së njësive vendore, grupi i punës mund të kërkojë zbatim të përshtatur sipas Kërkesës 1.5.

Kërkesa EITI 5:

EITI kërkon një proces të besueshëm përmes zbatimit të standarteve ndërkombëtare.

Vështrim i përgjithshëm - Kërkesa 5 kërkon krijimin e një procesi raportimi serioz në mënyrë që Raporti EITI të përmbajë të dhëna të besueshme. EITI kërkon të mbështetet tek sistemet ekzistuese të auditimit dhe garancive në qeveri dhe industri për të nxitur respektimin e praktikave dhe standardeve ndërkombëtare. Grupi ndër-institucional i punës duhet të emërojë një Administrator të Pavarur për të kryer kuadrimin e të dhënave të paraqitura nga kompanitë dhe subjektet qeveritare (5.1). Seksioni 5.2 evidenton çështjet që grupi i punës dhe Administrator i Pavarur duhet të marrin në konsideratë gjatë miratimit të Termave të Referencës për kuadrimin. Kjo përfshin garancitë që duhet të paraqesin subjektet raportuese. Seksioni 5.3 i jep fuqi Administratorit të Pavarur të vlerësojë nëse të dhënat e paraqitura janë të plota dhe të besueshme dhe të japë rekomandime për të ardhmen. Raporti EITI duhet të miratohet nga grupi i punës (5.4).

5.1 Caktimi i Administratorit të Pavarur

Kuadrimi i pagesave të kompanive dhe të ardhurave të qeverisë duhet të ndërmerret nga një Administrator i Pavarur përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare profesionale. Administratori i Pavarur duhet të jetë serioz, i besueshëm dhe i aftë nga pikëpamja profesionale. Emërimi i Administratorit të Pavarur bëhet nga grupi i punës.

5.2 Marrëveshja mbi Termat e Referencës të Administratorit të Pavarur

Grupi ndër-institucional i punës dhe Administratori i Pavarur duhet të bien dakord për termat e referencës në përputhje me “proceduren e miratuar për Raportet EITI”⁴ dhe bazuar në Termat standarde të Referencës të pranuar nga Bordi i EITI-t. Grupi i punës duhet të kërkojë aprovimin paraprak të Bordit në rast përshtatje apo devijimi nga këto procedura (Kërkesa 1.5). Gjatë rënies dakord për termat e referencës, grupi i punës dhe Administratori i Pavarur duhet:

4. “Procedurat e miratuara për Raportet EITI” dhe Termat standarte të Referencës janë siguruar nga Sekretariati Ndërkombëtar.

a) të miratojnë dokumentet standarte të raportimit për raportin EITI në përputhje me objektin e tij (shih Kërkesën 4).

b) të rishikojnë praktikat e auditimit dhe garancive. Është e nevojshme që grupi i punës, në konsultim me Administratorin e Pavarur, të shqyrtojë procedurat e auditimit dhe garancive në kompanitë dhe subjektet qeveritare që janë pjesë e procesit të raportimit, përfshirë ligjet dhe rregulloret përkatëse, reformat e planifikuara apo ato në proces, dhe të garantojë përputhshmërinë e këtyre procedurave me standartet ndërkombëtare.⁵ Rekomandohet që Raporti EITI të përfshijë një përmbledhje të gjetjeve.

c) Të bien dakord mbi garancitë që subjektet raportuese duhet t'i paraqesin Administratorit të Pavarur. Për të garantuar kredibilitetin e të dhënave, duhet që Termat e Referencës të përshkruajnë natyrën e informacionit që kompanitë pjesëmarrëse dhe entitetet qeveritare duhet t'i paraqesin Administratorit të Pavarur. Grupi i punës dhe Administratori i Pavarur duhet të dokumentojnë opsionet e analizuara dhe arsyetimin llogjik për garancitë që duhet të jepen. Nëse Administratori i Pavarur dhe grupi i punës e gjejnë të domosdoshme, garancitë mund të përfshijnë:

i. Një deklaratë nga një drejtuesi i lartë i kompanisë ose zyrtar i lartë i qeverisë për çdo subjekt raportues që vërteton se formulari i plotësuar i raportimit është i plotë dhe i saktë.

ii. Një letër konfirmimi nga audituesi i jashtëm i kompanive që konfirmon se informacioni i paraqitur prej tyre është i plotë dhe në përputhje me pasqyrat financiare të audituara. Grupi i punës mund të vlerësojë futjen graduale të kësaj procedure në mënyrë që letër-konfirmimi të integrohet në programin rutinë të punës së audituesit të kompanisë. Duhet të evidentohen qartë rastet kur ligji nuk sanksionon marrjen e një audituesi të jashtëm (të pavarur) për disa kompani, të cilat për këtë arsye nuk mund të paraqesin deklarata të tilla garancie, si dhe të theksohen reformat e planifikuara apo ato në proces.

iii. Subjekteve qeveritare raportuese mund t'ju kërkohet të marrin një vërtetim nga audituesi i tyre i jashtëm apo nga një organizëm ekuivalent nëse kjo gjë është e mundur dhe e përshtatshme.

d) Miratimin e dispozitave të duhura në lidhje me ruajtjen e informacionit konfidencial.

5. Për kompanitë: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) që lëshohen nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB). Për entet publike: Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) që lëshohen nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

e) Grupi ndër-institucional i punës duhet të bjerë dakord mbi nivelin e zbërthimit të të dhënave për publikim. Të dhënat e EITI-t duhet të paraqiten si zëra më vete sipas kompanisë, subjektit qeveritar apo fluksit të të ardhurave. Është e nevojshme që raportimi të bëhet në nivel projekti, me kusht që ai të jetë në përputhje me rregullat e Komisionit të Letrave me Vlerë dhe Bursave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kërkesat e Bashkimit Europian.

5.3 Vlerësimi dhe rekomandimet e Administratorit të Pavarur

a) Administratori i Pavarur, në përputhje me termat e references, duhet të përgatisë Raportin EITI që kuadron informacionin e deklaruar nga subjektet raportuese, duke identifikuar edhe mospërputhjet në rast se ka të tilla.

b) Administratori i Pavarur duhet të krijojë dosje elektronike të të dhënave të cilat mund të publikohen së bashku me Raportin EITI. Përmbledhja e të dhënave të çdo raporti duhet të dorëzohet në formë elektronike në Sekretariatit Ndërkombëtar EITI sipas formatit standard të raportimit të ofruar nga vetë Sekretariati.

c) Raporti duhet të përfshijë një vlerësim nga ana e Administratorit të Pavarur lidhur me besueshmërinë dhe plotshmerinë e të dhënave të paraqitura, e shoqëruar nga një përmbledhje informuese mbi veprimtarinë e kryer nga Administratori i Pavarur dhe kufizimet e ndeshura gjatë vlerësimit. Bazuar në deklaratimet e qeverisë për të ardhurat totale, sipas Kërkesës 4.2 (b), Administratori i Pavarur duhet të tregojë masën e mbulimit të rakordimit të kryer.

d) Vlerësimi duhet të përfshijë gjithashtu një vlerësim të faktit nëse informacioni i kërkuar është dhënë apo jo nga të gjitha kompanitë dhe subjektet qeveritare që janë objekt i procesit të raportimit. Çdo boshllëk apo dobësi në raportimin e bërë për Administratorin e Pavarur duhet të publikohet në raportin EITI, përfshirë emrat e subjekteve që nuk vepruan në përputhje me procedurat e rëna dakord, si dhe një vlerësim nëse ka gjasa që kjo të ketë ndikim të ndjeshëm në plotshmërinë e raportit.

e) Është e nevojshme që Raporti EITI të dokumentojë nëse kompanitë pjesëmarrëse dhe subjektet qeveritare kanë kryer auditimin e pasqyrave të tyre financiare për vitin financiar të mbuluar në raportin EITI. Cdo boshllëk në informacion ose dobësi duhet evidentuar. Kur gjendjet financiare e audituara se fundmi behen publike, rekomandohet që raporti EITI të keshillojë lexuesit për menyren se sit e aksesojne informacionin.

f) Administratori i pavarur mund të deshirojë të bëjë rekomandime për forcimin e procesit të raportimit në të ardhmen, përfaqësojë cdo rekomandim që i takon praktikave të auditimit dhe reformave që nevojiten për t'i bërë ato të njësueshme me standartet ndërkombëtare. Nëse Raportet e mëparshme EITI, kanë rekomanduar korrigjime dhe reforma, Administratori i Pavarur duhet të komentojë mbi progresin në implementimin e këtyre masave.

Kërkesa EITI 6

Raportet EITI duhet të jetë të kuptueshëm, gjithëpërshires, të promovohen në mënyrë aktive, të jenë lehtësisht të aksesueshëm nga publiku dhe të kontribuojnë në debatin publik.

Vështrim i përgjithshëm - deklarimi i rregullt i pagesave dhe të ardhurave të burimeve natyrore nga kompanitë nxjerrëse nuk sjell shumë dobi pa ndërgjegjësimin e publikut, të kuptuarit se çfarë tregojnë shifrat, dhe debatin publik rreth asaj sesi të ardhurat nga pasuritë natyrore mund të përdoren në mënyrë efikase. Kërkesa 6 siguron që palët e interesuara të angazhohen në dialog rreth menaxhimit të të ardhurave të burimeve natyrore.

6.1 Grupi ndër-institucional i punës duhet të sigurojë që Raporti të jetë i kuptueshëm, të promovohet në mënyrë aktive, të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga publiku dhe të kontribuojë në debatin publik. Audiencia kyçe duhet të përfshijë qeverinë, deputetët, shoqërinë civile, kompanitë dhe median. Grupi i punës duhet:

- a) Të përgatisë kopje në letër të Raportit, dhe të sigurojë shpërndarjen e gjerë të tyre. Në rastet kur raporti përmban të dhëna të zgjeruara, p.sh. dosje voluminoze, grupi i punës inkurajohet t'i bëjë ato të disponueshme në formë elektronike (internet).
- b) Ta bëjë Raportin e EITI të disponueshëm në formë elektronike dhe të njoftojë se ku mund të gjendet ai.
- c) Të sigurojë që Raporti të jetë i kuptueshëm, i shkruar në një stil të qartë dhe të kapshëm, si dhe në gjuhën e duhur.
- d) Të sigurojë që aktivitetet e organizuara në terren nga qeveria, shoqëria civile apo kompanitë, janë ndërmarrë për të rritur ndërgjegjësimin dhe lehtësuar dialogun në të gjithë vendin në lidhje me Raportin EITI.

6.2 Grupi i punës inkurajohet t'i bëjë Raportet e EITI të lexueshëm nga kompjuterat, dhe t'u vendos atyre kode apo etiketa (tag) në mënyrë që të lejojë krahasimin e informacionit me të dhëna të tjera të disponueshme për publikun. Kërkesa 3.7 (b) inkurajon grupin e punës t'i referohet sistemeve kombëtare të klasifikimit të të ardhurave dhe standardeve ndërkombëtare të tilla si Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë. Grupi i punës rekomandohet:

- a) Të hartojë raporte të shkurtra përmbledhëse që përmbajnë një analizë të qartë dhe të balancuar të informacionit, duke deklaruar në mënyrë të qartë autorësinë e elementëve të ndryshëm të Raportit.

b) Të përmbledhë dhe krahasojë shumën e çdo fluksi të ardhurash me shumën totale të të ardhurave që shkon për secilin nivel përkatës të qeverisë.

c) Të analizojë mundësinë e deklaramit në mënyrë të vazhdueshme në formë elektronike të të ardhurave të qeverisë dhe pagesave nga kompanitë nxjerrëse, në rastet kur kjo është ligjërish dhe teknikisht e mundur. Kjo përfshin rastet kur të dhënat mbi të ardhurat nga industria nxjerrëse janë duke u publikuar tashmë rregullisht nga qeveria ose kur sistemet kombëtare të taksave janë duke u orientuar drejt deklarimeve dhe pagesave on-line të detyrimeve tatimore. Raportimi i vazhdueshëm nga ana e Qeverisë mund të shihet si raportim i ndërmjetëm, dhe si element integral i procesit kombëtar EITI i përfshirë në Raportin EITI që publikohet çdo vit.

d) Të ndermarre përpjekje për krijimin e kapaciteteve, sidomos me shoqërinë civile dhe përmes organizatave të shoqërisë civile, me qëllim që të rrisë sensibilizimin për procesin, të përmirësojë të kuptuarit e informacionit dhe të të dhënave të raporteve, dhe të inkurajojë përdorimin e informacionit nga qytetarët, mediat, e të tjerë.

Kërkesa EITI 7

EITI kërkon që grupi ndër-institucional i punës të ndërmarrë hapa për të vepruar mbi bazën e mësimave të nxjerra si dhe të analizojë rezultatet dhe ndikimet nga zbatimi i EITI.

Vështrim i përgjithshëm – Reportet e EITI çojnë drejt përmbushjes së Parimeve të EITI-t duke kontribuar për një debat publik më të gjerë. Gjithashtu, është thelbësore të vihen në jetë mësimet e nxjerra gjatë implementimit, të shpjegohen, dhe nëse është e nevojshme, të trajtohen mospërputhjet e evidentuara në Raportin EITI si dhe të hidhen themele të qëndrueshme dhe të sigurta për zbatimin e EITI-t.

7.1 Grupi ndër-institucional i punës duhet të ndërmarrë hapa për të vepruar mbi bazën e mësimave të nxjerra; për të identifikuar, analizuar dhe trajtuar shkaqet e mospërputhjeve; dhe të marrë në konsideratë rekomandimet e Administratorit të Pavarur për përmirësim në të ardhmen.

7.2 Grupi i punës duhet të analizojë rezultatet dhe ndikimet nga zbatimi i EITI-t në kuadrin e menaxhimit të burimeve natyrore.

a) Grupi i punës është i detyruar të publikojë raporte vjetore mbi veprimtarinë e tij.⁶ Raporti vjetor duhet të përfshijë:

6. Formulari standard është i disponueshëm nga Sekretariati Ndërkombëtar

i. Një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara gjatë vitit parardhës.

ii. Një vlerësim të progresit të bërë në përmbushjen dhe ruajtjen e përputhshmërisë me çdo kërkesë EITI, dhe hapat e ndërmarrë për t'i kapërcyer këto kërkesa. Kjo përfshin masat e marra për trajtimin e çështjeve të tilla si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet (3.7-3.8), pagesat e transportit (4.1.f), shpenzimet sociale diskrecionale (4.1.e), transfertat ad-hoc në nivel vendor (4.2.e), pronësinë e dobishme (3.11) dhe kontratat (3.12).

iii. Një përmbledhje të përgjigjeve të grupit të punës dhe përparimit të bërë në adresimin e rekomandimeve për procesin e rakordimit dhe vlerësimit në përputhje me kërkesat e 7.1.a. Një renditje të të gjitha rekomandimeve dhe aktiviteteve përkatëse që janë ndërmarrë për adresimin e tyre.

iv. Një vlerësim të progresit të bërë për arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e tij të punës (Kërkesa 1.4), përfshirë ndikimet dhe rezultatet e tyre.

v. Një përshkrim të përpjekjeve për të forcuar zbatimin e EITI-t, përfshirë veprimet për zgjerimin e detajimit dhe fushës së raportimit ose për të rritur angazhimin e palëve e interesuara.

b) Të gjitha palët e interesuara duhet të jenë pjesë e procesit të përgatitjes së raportit vjetor dhe analizës së ndikimeve nga zbatimi i EITI-t. Grupet e shoqërisë civile dhe industrisë të përfshira në EITI, në mënyrë të veçantë ata që janë pjesë e grupit ndër-institucional të punës, duhet të japin komentet e tyre (feedback) në lidhje me procesin, ndërkohë që pikëpamjet e tyre duhet të pasqyrohen në raportin vjetor të punës.

c) Grupi i punës duhet të paraqesë Raportin e Validimit (Vlerësimit) në përputhje me afatet e përcaktuara nga Bordi i EITI-t (Kërkesa 1.6)

3 Udhëzuesi i Validimit (vlerësimit)

Ky kapitull fokusohet në Validimin (vlerësimin) EITI. Qëllimi i Validimit është të vlerësojë përputhshmërinë me Kërkesat EITI të parashtruara në kapitullin 2.

3.1 Vështrim i përgjithshëm për Validimin

Validimi është një element esencial i procesit EITI. Ai shërben për të vlerësuar performancën dhe promovon dialogun dhe të mësuarit në nivel vendi. Ai mbron gjithashtu integritetin e EITI-t, për aplikimin e standardeve të njëjta globale për të gjitha vendet zbatuese.

Validimi është një mekanizëm i jashtëm dhe i pavarur vlerësimi, që kryhet nga një Validator (Vlerësues) i caktuar nga Sekretariati Ndërkombëtar. Ai ka si qëllim t'u ofrojë të gjitha palëve të interesuara një vlerësim të paanshëm në lidhje me përputhshmërinë e zbatimit të EITI-t me Standardin EITI. Raporti i Validimit trajton ndikimin e EITI-t, mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të tij si dhe shqetësimet e ngritura nga palët e interesuara së bashku me rekomandimet për implementimin tij në të ardhmen.

Duke pasur parasysh natyrën e grupit të punës dhe rëndësinë e dialogut, procedura e Validimit e vë theksin tek konsultimi midis grupeve të ndryshme të interesit. Grupi i punës luan rol qendror në sigurimin e një procesi Validimi të plotë dhe gjithëpërfshirës. Grupet e interesit të EITI-t kanë mundësi që gjatë gjithë këtij procesi të shprehin mendimin e tyre mbi efikasitetin e zbatimit të tij, përmbushjen e Kërkesave, dhe të bëjnë sugjerime për mënyrën e konsolidimit të procesit. Përveç konsultimeve me grupet e interesit, Vlerësuesi duhet të analizojë me kujdes Raportet EITI dhe të takohet me Administratorin e Pavarur për të diskutuar pikat e forta dhe të dobëta të procesit.

Siç theksohet edhe në kapitullin 2, ekzistojnë dy grupe të vendeve zbatuese: Vend kandidat dhe vend anëtar i EITI-t. Statusi kandidat është një periudhë e limituar që të çon, në kohën e duhur, në marrjen e statusit (të përputhshmërisë) anëtar të EITI. Vendet candidate të EITI-t duhet të fillojnë Validimin (Vlerësimin) brenda dy viteve e gjysëm nga data e pranimit si vend kandidat. Nëse raporti i Validimit vlerëson se një vend i ka përmbushur të gjitha kërkesat, ai bëhet vend anëtar (në përputhje) përmes vendimit të Bordit. Vendet anëtare duhet të realizojnë procesin e Validimit çdo tre vjet pas pranimit të tyre. Nëse një vend nuk arrin të marrë statusin e vendit anëtar, ai mundet që në disa rrethana të ruajë statusin e tij si vend kandidat edhe për një periudhë shtesë (shih Kërkesa 1.6).

Në të gjitha vendimet mbi Validimin, Bordi i jep përparësi domosdoshmërisë për trajtim të krahasueshëm midis vendeve dhe për të mbrojtur integritetin e EITI-t. Komiteti i Validimit i Bordit të EITI-t shqyrton dhe jep komente mbi të gjitha projekt-raportet dhe raportet finale të Validimit. Validimi nuk konsiderohet i përfunduar derisa Komiteti i Validimit të gjykojë se Raporti final i Validimit është gjithëpërfshirës dhe ofron një bazë të përshtatshme për të përcaktuar pajtueshmërinë e vendit me kërkesat EITI, kapitulli 2, Kërkesat 1.6-1.7 përmbajnë informacion shtesë në lidhje me afatet, rregullat dhe procedurat e validimit për përcaktimin e statusit të një vendi pas Validimit.

3.2 Hapat e Proçesit të Validimit

1. Sekretariati Ndërkombëtar informon grupin ndër-institucional te punes në lidhje me programin e Validimit. Çdo vend zbatues duhet të kryejë Validimin në përputhje me programin e rënë dakord me Bordin e EITI-t. Sekretariati Ndërkombëtar, mbikqyr procesin në konsultim me

grupin ndër-institucional te punes, duke përfshirë edhe rënien dakord mbi një afat kohor për përfundimin e procesit të Validimit.

2. Gjetja e një Vlerësuesi. Sekretariati Ndërkombëtar kryen procesin e prokurimit për gjetjen e një Vlerësuesi. Porcedura për këtë hap është dhënë në seksionin 3.3

3. Validimi. Vlerësuesi vlerëson respektimin e Standardeve EITI, duke vlerësuar respektimin e shtatë Kërkesave EITI (shiko seksionin 3.4). Validimi është një proces konsultativ. Vlerësuesi takohet me grupin ndër-institucional, Administratorin e Pavarur dhe palë të tjera të interesuara, duke përfshirë grupet e interesit që janë të përfaqësuara në grupin ndër-institucional. Vlerësuesi duhet të konsultohet me dokumentacionin në dispozicion, duke përfshirë:

- Planin e punës së EITI-t dhe dokumente të tjera të planifikimit të tilla si buxhetet dhe planet e komunikimit.
- Termat e Referencës së grupit ndër-institucional te punes dhe procesverbalet e mbledhjeve të tij.
- Raportet EITI, dhe informacionin shtesë si raportet përmbledhëse dhe studime të fushës së aktivitetit.
- Materiale të komunikimit.
- Raportet vjetore të aktivitetit.
- Informacione të tjera me rëndësi për Validimin.

4. Projekt-Raporti i Validimit. Vlerësuesi do të prodhojë një Projekt-Raport Validimi, duke përdorur formate standarde të disponueshme nga Sekretariati Ndërkombëtar. Ky përfshin:

- **Një hyrje që trajton:**
- Karakteristikat kryesore të industrive nxjerrëse në vend;
- Progresin e përgjithshëm në zbatimin e planit të punës së EITI-t;
- Përmbledhje e angazhimit nga qeveria, organizatat e shoqërisë civile dhe industria.
- Një vlerësim të plotë dhe të detajuar nga Vlerësuesi mbi respektimin e secilës prej kërkesave, duke marrë parasysh pikëpamjet palëve të interesuara. Kjo duhet të përfshijë një tabelë përmbledhëse të përfundimeve të Vlerësuesit.
- Gjykimin e Vlerësuesit nëse vendi ka plotësuar të gjitha Kërkesat EITI.

- **Një Raport narrativ që trajton:**
- Ndikimin e EITI-t, përfshirë progresin në prioritetet kombëtare për industrinë nxjerrëse të identifikuar në planin e punës të grupit ndër-institucional. Gjithashtu duhet të evdientohet çdo lloj pengese për ndikimin e EITI-t.
- Qëndrueshmërinë e procesit.
- Çdo risi dhe veprim të ndërmarrë nga grupi ndër-institucional që tejkalon kërkesat e EITI-t, p.sh. praktikat e mira si dhe përpjekjet për të thelluar dhe zgjeruar fushën e EITI-t, në nivelet e sipërme apo të poshtme të sektorit, apo në sektorë të tjerë.
- Përfundimet, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për rritjen e ndikimit më të gjerë të procesit EITI.

Vlerësuesit mund të dëshirojnë të komentojnë mbi mundësitë për të qartësuar dhe forcuar Standardin EITI dhe procedurat e Validimit.

5. Vlerësuesi përgatit Projekt-Raportin e Validimit. Projekt-Raporti i Validimit duhet t'i dorëzohet grupit ndër-institucional dhe Komitetit të Validimit të Bordit të EITI-t. Rishikimi nga Komiteti i Validimit kërkon të sigurojë që Raporti i Validimit është gjithëpërfshirës dhe ofron një bazë të përshtatshme për vlerësimin e pajtueshmërisë së vendit me kërkesat EITI. Grupi ndër-institucional do të ftohet për të dhënë komente të detajuara. Raporti përfundimtar i Vlerësuesit duhet të adresojë në mënyrë të plotë komentet e Komitetit të Validimit dhe grupit ndër-institucional.

6. Vlerësuesi përgatit Raportin përfundimtar të Validimit. Raporti përfundimtar i Vlerësuesit i paraqitet Komitetit të Validimit. Gjithashtu, grupi ndër-institucional ftohet për të bërë komente të detajuara. Raporti përfundimtar i Vlerësuesit dhe të gjitha komentet e bëra nga grupi ndër-institucional publikohen në www.eiti.org.

7 Bordi i EITI-t analizon Raportin përfundimtar të Validimit dhe vendos për statusin e vendit zbatues (shih kapitullin 2, Kërkesat 1.6. - 1.7). Bordi mund të bëjë rekomandime për rritjen e ndikimit më të gjerë të EITI-t. Në rast se Raporti përfundimtar i Validimit nuk jep informacion të hollësishëm në lidhje me respektimin e kërkesave, Bordi i EITI-t mund t'i kërkojë Vlerësuesit të sigurojë informacion shtesë.

8. Ankimimi. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet qeverisë, grupit ndër-institucional ose Bordit të EITI-t në lidhje me Raportin e Validimit duhet së pari të trajtohet nga Vlerësuesi i cili punon me këto grupe. Vlerësuesi duhet të bëjë ndryshimet e duhura në Raportin e Validimit në rast se

mosmarrëveshja është e zgjidhshme. Në rast të kundërt, ajo duhet të evidentohet në Raportin e Validimit. Mosmarrëveshjet serioze në lidhje me procesin e Validimit duhet t'i paraqiten Bordit të EITI-t, i cili do të përpiqet të gjejë zgjidhjen e tyre. Bordi i EITI-t ka të drejtë të refuzojë ankesat që konsiderohen të parëndësishme, të bezdisshme ose të pabaza (shih kapitullin 2, Kërkesa 1.8).

3.3 Përzgjedhja e Vlerësuesit

Sekretariati Ndërkombëtar mbikqyr procesin e prokurimit të Vlerësuesit. Seksioni në vijim paraqet hapat kryesore të këtij procesi.

1. Sekretariati Ndërkombëtar informon grupin e punës për fillimin e procesit të Vlerësimit, dhe harton Termat e Referencës për Vlerësimin.

Termat e Referencës përcaktojnë:

- a) Objektivat dhe dokumentet që duhet të dorëzohen në kuadër të Vlerësimit.
- b) Afatet kohore.
- c) Procesin e Validimit, përfshirë procedurat e rishikimit dhe komentimit të projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare të Vlerësimit.
- d) Rolin dhe përgjegjësitë e grupit të punës, së bashku me dokumentet që duhet t'i dorëzohen Vlerësuesit përpara fillimit të tij.

2. Sekretariati Ndërkombëtar do të përzgjedhë një Vlerësues nga lista e organizatave të akredituara, e cila është aprovuar paraprakisht nga Bordi i EITI-t përmes procesit të tenderimit. Sekretariati Ndërkombëtar vlerëson ofertat teknike dhe financiare në përputhje me kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në termat standarde të referencës për Vlerësuesit. Gjatë vlerësimit, Sekretariati Ndërkombëtar do të marrë parasysh, ndër të tjera, edhe:

- a) Trajtimin e konfliktit të interesit.
- b) Përshtatshmërinë e ofertave në lidhje me objektivin dhe metodologjinë e Vlerësimit.
- c) Mundësitë për partneritet me firmat lokale.
- d) Koherencën e ofertave teknike dhe financiare të Vlerësuesit.

Bordi i EITI-t, rezervon të drejtën të rishikojë në çdo kohë procedurat e prokurimit dhe listën e Vlerësuesve të akredituar.

3. Sekretariati Ndërkombëtar përpilon një listë të ngushtë të ekipeve të mundshëm të validimit dhe i paraqet grupit të punës rekomandimet e tij. Grupit të punës do t'i kërkohet të japë pëlqimin e tij për Vlerësuesin e propozuar. Në rast mospajtimi me rekomandimin e

Sekretariatit Ndërkombëtar, grupi i punës duhet të paraqesë arsyet e kundërshtimit. Sekretariati Ndërkombëtar vendos më pas nëse do të emërojë dikë tjetër nga lista e ngushtë e Vlerësuesve.

4. Kontrata e Validimit bëhet midis Sekretariatit Ndërkombëtar dhe Vlerësuesit të miratuar. Kontrata do të qartësojë më tej përgjegjësitë dhe detyrimet e Vlerësuesit ndaj Bordit të EITI-t dhe Sekretariatit Ndërkombëtar. Ajo përmban, ndër të tjera, udhëzime mbi:

- Krijimin e një komunikimi të fortë dhe shkëmbimi efikas të informacionit ndërmjet Sekretariatit Ndërkombëtar, grupit ndër-institucional dhe Vlerësuesit gjatë gjithë procesit të Validimit.
- Raportimin e vështirësive apo parregullsive të hasura gjatë procesit.
- Mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Palët e interesuara që dëshirojnë të ngrejë shqetësime lidhur me përzgjedhjen e Vlerësuesit, Termat e Referencës apo Kontratën, mund të kontaktojnë Sekretariatit Ndërkombëtar, i cili, sipas rastit, do t'ia përcjellë ankesat Bordit të EITI-t.

3.4 Metodologjia e Vlerësimit

Vlerësuesi bën vlerësimin e përputhshmërisë së një vendi me 7 Kërkesat e EITI-t, në përputhje me Termat standard të Referencës për Vlerësuesit, të aprovuara nga Bordi i EITI-t dhe të disponueshme nga Sekretariati Ndërkombëtar, dhe mbështetur në analizën e dokumenteve relevante dhe komenteve të dhëna nga palët e interesuara.

Secila prej kërkesave duhet të vlerësohet si “e plotësuar” apo e “paplotësuar”. Ndërkohë që disa nga kërkesat i nënshtrohen një vlerësimi objektiv, të tjerat janë më komplekse, më të ndër-lidhura dhe mund të kërkojnë gjykimin subjektiv të Vlerësuesit. Gjatë vlerësimit të kërkesave, Vlerësuesi duhet t'i bashkangjise çdo kërkesë një nga përcaktimet e mëposhtme:

Kërkesë e plotësuar: Zbatimi i EITI-t plotëson standardin e kërkuar, dmth pragon e përputhshmërisë.

Kërkesë e paplotësuar me progres domethënës: Pak progres në zbatimin e EITI-t, por nevojiten veprime të mëtejshme në mënyrë që kërkesa të konsiderohet e përmbushur.

Kërkesë e paplotësuar me progres të kufizuar: Evidenca të pakta në lidhje me progresin drejt përputhshmërisë. Nevojiten veprime shtesë të konsiderueshme në mënyrë që kërkesa të konsiderohet e plotësuar.

Termat e Referencës për Vlerësuesit përmbajnë udhëzime specifike për vlerësimin e çdo kërkesë në përputhje me këtë klasifikim. Vlerësuesi duhet të shprehë në mënyrë të qartë për çdo kërkesë arsyetimin ku mbështetet vlerësimi i tij dhe të citojë evidenca kyçe nga dokumentet dhe pikëpamjet e palëve të interesuara. Në rast se vendi ka bërë përparim domethënës ose të limituar, por nuk i ka përmbushur plotësisht kërkesat, vlerësuesi jep rekomandime mbi veprimet përmirësuese të nevojshme për të arritur përputhshmërinë. Në rast se vendi i ka përmbushur kërkesat, Vlerësuesi jep rekomandime, nëse është e mundur, për përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit, duke marrë parasysh edhe mendimet e grupeve të interesit.

4 Protokoli: Pjesëmarrja e shoqërisë civile

Miratuar nga Bordi i EITI-t në 16 Shkurt 2011.

Protokoli përmban rekomandime për angazhimin e shoqërisë civile në EITI, duke u mbështetur në mësimet e nxjerra nga zbatimi i tij në nivel kombëtar. Vendet zbatuese dhe ato aplikante janë angazhuar të mbështesin Kërkesat e EITI-t, duke garantuar përfshirjen aktive të shoqërisë civile. Për rrjedhojë, Bordi i EITI-t kujdeset për rolin e tij duke garantuar përmbushjen e kërkesave në lidhje me pjesëmarrjen e shoqërisë civile.

Parimi 2 i EITI-t afirmon se “menaxhimi i pasurive të burimeve natyrore në dobi të qytetarëve të një vendi është kompetencë e qeverive sovrane, e cila ushtrohet në interes të zhvillimit të tyre kombëtar”.

Parimi 12 përcakton se “të gjitha palët e interesuara duhet të japin një kontribut të rëndësishëm dhe relevant për të çuar përpara parimet dhe standardet e EITI-t”.

Kriteri 5 kërkon që “shoqëria civile të angazhohet në mënyrë aktive në hartimin, ndjekjen dhe vlerësimin e këtij procesi dhe të japë kontributin e saj në debatin publik”.

Kërkesa 6 udhëzon qeverinë “...të sigurojë përfshirjen e plotë, të pavarur, aktive dhe efikase të shoqërisë civile”.

Roli i shoqërisë civile

Parimet dhe Kriteret nënvizojnë rëndësinë thelbësore të pjesëmarrjes së lirë, të plotë, të pavarur, aktive dhe efikase të shoqërisë civile [këtu e më poshtë referuar si pjesëmarrja e shoqërisë civile]. Organizatat e shoqërisë civile janë aktorë kyç në debatet publike rreth EITI-t dhe çështjeve lidhur me transparencën. Këto përpjekje janë të rëndësishme dhe plotësojnë përpjekjet e grupeve të tjera të interesit. Megjithëse disa vende mund të jenë pranuar në EITI me përfshirje

të kufizuar të shoqërisë civile, duhet t'i kushtohet rëndësia e duhur faktit që pjesëmarrja e shoqërisë civile në të gjitha fazat e procesit të EITI-t është thelbësore.

Qeveria, kompanitë dhe shoqëria civile në vendet zbatuese po bashkëpunojnë për t'i dhënë formë procesit përmes grupit ndër-institucional të punës (MSG). Grupi ndër-institucional pasqyron strukturën e Bordit të EITI-t, ku të gjitha palët kryesore të interesuara luajnë një rol kyç në përcaktimin e mënyrës së drejtimit të EITI-t.

Mësimet e nxjerra

EITI ka hasur një sërë pengesash dhe kufizimesh që ndikojnë në angazhimin e shoqërisë civile në EITI, përfshirë veprimet që kanë kufizuar debatin publik në lidhje me transparencën e të ardhurave dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Bordi i EITI-t është përpjekur t'i trajtojë këto sfida, duke ofruar një sërë përgjigjesh, përfshirë ngritjen e një Komiteti të Reagimit të Shpejtë që merret me trajtimin e kërcënimeve apo ngacmimeve konkrete ndaj përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Gjithashtu, Bordi i EITI-t ka ngritur Grupin e Punës për Pjesëmarrjen e Shoqërisë Civile, i cili ofron udhëzime të mëtejshme mbi angazhimin e shoqërisë civile në EITI.

Në disa raste, qeveritë kanë argumentuar se kufizimet ndaj organizatave të shoqërisë civile nuk kanë lidhje me përfshirjen e tyre në EITI. Kjo është ajo që konsiderohet si dilema e lidhjes, që do të thotë se është e vështirë të përcaktohet se deri në ç'mase veprimet e grupeve të interesit dhe kufizimet ndaj tyre kanë pasur lidhje direkte apo kanë penguar zbatimin e EITI-t. Megjithatë, siç është theksuar, hapësira për angazhimin e shoqërisë civile është një përbërës i domosdoshëm në procesin e EITI-t.

Shqetësimet themelore të ngritura deri më sot kanë të bëjnë me sa me poshte⁷:

- Ngacmimin dhe frikësimin e përfaqësuesve të shoqërisë civile që marrin pjesë në zbatimin e EITI-t.
- Mohimin e lejeve të udhëtimit të kërkuara nga përfaqësues të shoqërisë civile për të marrë pjesë në takime të ngjashme.
- Barrierat ligjore, administrative, proceduriale dhe barrierat tjera për regjistrimin dhe funksionimin e pavarur të shoqërisë civile.
- Pengesa për zgjedhjen e lirë të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

7. Raste të veçanta që janë të adresuara nga bordi EITI janë të listuara në dokumentin e Sekretariatit të titulluar Shqyrtimi i Pengesave dhe Kufizimeve për pjesëmarrjen e Shoqërisë Civile

- Përfshirja e deputetëve nga partia në pushtet apo parti të tjera politike në aleancë me qeverinë si përfaqësues të “shoqërisë civile”, në kundërshtim me parimin bazë të pasqyruar në Kërkesën 6.
- Kufizimet në burime dhe kapacitete.

Deri më tani, Bordi i EITI-t ka trajtuar shpesh çështje lidhur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në vendet zbatuese pa kaluar në gjykimin e detajeve. Ndërkohë Bordi i EITI-t, përmes Komitetit të Reagimit të Shpejtë, ka ndjekur përgjithësisht përjasjen e mëposhtme:

- Ka rikonfirmuar rëndësinë e përputhshmërisë me Parimet, Kriteret dhe Rregullat e EITI-t.
- Ka bërë të qartë rastet e mos-respektimit të këtyre Parimeve, Kritereve dhe Rregullave.

Veprimet konkrete të Bordit të EITI-t variojnë nga vizitat diplomatike publike dhe jo-publike tek rekomandimet për pezullim vullnetar nga EITI, duke respektuar faktin se qeveria qendrore, në bashkëpunim me grupin ndër-institucional, mban gjithmonë përgjegjësinë e zbatimit të EITI-t. Veprimet e Bordit kanë forcuar zbatimin e nismës në përgjithësi, dhe duhet të shikohen si pjesë plotësuese e përpjekjeve të aktorëve të tjerë të EITI-t.

Fuqizimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile

Si guardian i Parimeve dhe Kritereve EITI, Bordi i EITI-t i kushton rëndësi angazhimit aktiv të shoqërisë civile, bashkë me aktorë të tjerë kyç, në hartimin, ndjekjen dhe vlerësimin e procesit.

Angazhimi i qeverisë për të punuar me shoqërinë civile

Kriteret e EITI-t kërkojnë nga qeveritë kombëtare të angazhohen për të punuar me shoqërinë civile për zbatimin e EITI. Vendet duhet të adresojnë qysh në fazat e hershme pengesat ndaj përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e zbatimit. Në mënyrë të veçantë, ato duhet të sigurojnë kushtet e përshtatshme për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile. Probleme shqetësuese mund të përbëjnë barrierat ligjore ose rregullatore ndaj pjesëmarrjes së lirë dhe aktive të shoqërisë civile në zbatimin e EITI-t, dhe pavarësisht faktit nëse janë apo jo përfaqësuesit e shoqërisë civile të përfshirë në masë të konsiderueshme në këtë proces, ata gëzojnë të drejta thelbësore të njohura ndërkombëtarisht e të përshkruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Përfshirja në grupin ndër-institucional të punës

Grupet e interesit nga shoqëria civile kanë raportuar vështirësi në disa procese në vend që kanë të bëjnë me përcaktimin e mënyrës së përfaqësimit të grupeve të shoqërisë civile. Është shumë e

rëndësishme që të lejohet shoqëria civile t'i zgjedhë vetë përfaqësuesit e saj në grupin ndër-institucional të punës, dhe të sigurohet pavarësia e tyre nga qeveria, kompanitë, dhe parlamenti, si nga pikëpamja funksionale dhe në terma të politikës, në mënyrë që të garantohet marrja në konsideratë e interesave të grupeve të shoqërisë civile.

Adresimi i nevojave për kapacitete

Zhvillimi i kapaciteteve për shoqërinë civile mund të jetë i nevojshëm për t'i dhënë asaj mundësi të luajë një rol aktiv në procesin e zbatimit. Duhet t'i kushtohet rëndësia e duhur zbutjes së ndikimeve të pengesave teknike dhe financiare në lidhje me pjesëmarrjen adekuate të shoqërisë civile, duke lehtësuar aksesin e tyre në trajnime dhe burime për çështje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në EITI.

Siguria e përfaqësuesve të shoqërisë civile pjesë e EITI

Megjithëse deklaratimet ose raportimet për ngacmim të mundshëm apo real të përfaqësuesve të shoqërisë civile në vendet zbatuese të EITI duhet të adresohen në radhë të parë nga grupi ndër-institucional, Bordi i EITI-t mund të thirret të hetojë raste të veçanta dhe adresojë sipas rastit shkeljet e Kriteve dhe Parimeve të EITI.

PJESA E II

QEVERISJA DHE MENAXHIMI

EITI ka evoluar nga një koncept në një standard me rregulla dhe procedura të hollësishme i cili ofron një platformë për debat dhe reforma më të gjera. Ndërkaq, edhe qeverisja dhe menaxhimi i EITI-t kanë evoluar. EITI drejtohet nga një shoqatë jo-fitimprurëse të miratuar sipas ligjit Norvegjez. Statuti i Shoqërisë siguron kuadrin drejtues për EITI-n.

EITI organizon një Konferencë Globale të paktën çdo tre vjet, që synon krijimin e një forumi ndërkombëtar për grupet e interesit për të çuar më tej objektivat e EITI-t. Krahas këtyre Konferencave, zhvillohet edhe Mbledhja e Anëtarëve ku marrin pjesë tre grupe përfaqësuese: vendet (zbatuese dhe mbështetëse), kompanitë (përfshirë investitorët institucionalë) dhe organizatat e shoqërisë civile me të drejtë të barabartë vote. Një nga detyrat kryesore të Mbledhjes së Anëtarëve është të emërojë Bordin e EITI-t. Të gjitha vendet zbatuese dhe mbështetëse kanë të drejtë të jenë anëtare të Organizatës EITI. Është në dorën e përfaqësive të bien dakord ndërmjet tyre për anëtarësimin në Organizatë dhe se kë dëshirojnë të emërojnë në Bordin e EITI-t. Bordi i EITI-t mbikqyr aktivitetet e nismës ndërmjet konferencave dhe mbledhjeve të Shteteve Anëtare. Kjo kryhet përmes tre deri në katër mbledhjeve në vit plus


qarkoreve të shpeshta të Bordit që përmbajnë propozimet për miratim, dhe disa komiteteve. Bordi i EITI-t ka 20 anëtarë, ku grupet e ndryshme gëzojnë të drejtën e përfaqësimit. Kryetari duhet të jetë i pavarur.

Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-t, është përgjegjës për drejtimin rutinë të Organizatës EITI. Vendeve zbatuese të EITI-t, u ofrohet asistencë e madhe teknike. Pjesa më e madhe e asistencës sigurohet nga Banka Botërore, përmes Fondit të saj për EITI-n. Ekziston një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet EITI-t dhe Bankës Botërore.

Ekzistojnë edhe shumë ofrues të tjerë në lidhje me asistencë teknike të ofruar për proceset e EITI-t.

Ky seksion përmban dokumentet kryesore në lidhje me drejtimin e EITI-t në nivel ndërkombëtar:

- Statuti i Organizatës
- Përdorimi i emrit dhe logos së EITI-t
- Politika e Transparencës, e adoptuar në vitin 2013, e cila përcakton sesi vetë EITI duhet të jetë transparent.
- Projekt-Udhëzimet e Përfaqësimit i përditesuar, i cili ofron udhëzime për mënyrën se si duhet të organizojnë veten përfaqësitë e ndryshme.



5 STATUTI

NENI 1 EMRI

1) Emri i organizatës do të jetë “Organizata e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)” (këtu e më poshtë referuar si “Organizata EITI”).

NENI 2 HISTORIKU DHE OBJEKTIVI

1) Organizata EITI është një iniciativë ndërkombëtare shumë-palëshe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga qeveritë dhe agjencitë e tyre; kompanitë e naftës, gazit dhe minierave; kompanitë e menaxhimit të aseteve dhe fondeve të pensioneve (këtu e mëposhtë referuar si "Investitorë institucionalë") dhe grupet kombëtare të shoqërisë civile dhe organizmat ndërkombëtare joqeveritare.

2) Objektivi i Organizatës EITI është t'i bëjë Parimet, Kërkesat dhe standardet EITI ndërkombëtarisht të pranuar për transparencën në sektorët e naftës, gazit dhe minierave, duke patur parasysh se rritja e transparencës së të ardhurave të burimeve natyrore mund të reduktojë korrupsionin, dhe të ardhurat nga industritë nxjerrëse mund të transformojnë ekonominë, zvogëlojnë varfërinë, dhe të rrisin standardet e jetesës të të gjitha popullsisë në vendet e pasura në burime.

NENI 3 PERSON LIGJOR ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

1) Organizata EITI është një Organizata jo-fitimprurëse e organizuar sipas ligjit norvegjez ("forening").

2) Anëtarët e Organizatës EITI nuk janë përgjegjës, individualisht ose kolektivisht, për asnjë nga borxhet apo detyrimet e saj.

NENI 4 ORGANIZIMI

1) Organet e përhershme institucionale të Organizatës EITI janë:

- i) Mbledhja e Anëtarëve, e cila mbahet në lidhje me Konferencën e EITI-t,
- ii) Bordi i cili drejtohet nga Kryetari;
- iii) Sekretariati i drejtuar nga Kreu i Sekretariatit;

2) Bordi mund të krijojë komitete në përputhje me nenin 14;

3) Organizata EITI vepron në mënyrë transparente.

NENI 5 ANËTARËSIA DHE GRUPET E PËRFAQESIMIT

1) Një anëtar i Organizatës EITI është një përfaqësues personal i një vendi (shteti), kompanie, organizate, personi juridik apo enti ligjor që është caktuar nga një Përfaqësi sipas përcaktimeve në Nenet 5 (2) dhe (3).

2) Anëtarët janë të organizuar në tre Përfaqësi që janë:

i) Grupi i Vendeve, të cilat përfshijnë:

a) Vendet (shtetet) zbatues, të cilat janë të klasifikuara nga Bordi i EITI-t ose si vende kandidatë apo si vende në përputhje me rregullat (anëtare); dhe

b) Vendet Mbështetëse, që do të thotë shtete apo bashkim shtetesh, të cilat mbështesin objektivat e EITI-t.

ii) Grupi i kompanive, që përfshin:

a) Kompanitë në sektorin e industrisë nxjerrëse të angazhuara për të mbështetur objektivin e Organizatës EITI dhe shoqatat që përfaqësojnë këto kompani; dhe

b) Investitorët institucionalë të angazhuar për të mbështetur objektivat e EITI-t.

iii) Grupi i Organizatave të Shoqërisë Civile, të cilat përfshijnë organizatat joqeveritare, rrjetet globale të veprimit ose koalicionet që mbështesin objektivin e EITI-t.

3) Secila përfaqësi vendos për rregullat e veta që udhëheqin emërimet e Anëtarëve të Organizatës EITI. Anëtarësia kufizohet vetëm në:

i) një përfaqësues nga secili Vend Zbatues dhe secili vend Mbështetës (ose bashkim i tyre) për grupin e vendeve;

ii) një përfaqësues nga çdo kompani dhe shoqatë që i përfaqëson ato, si dhe pesë përfaqësues nga Investitorët Institucionalë për grupin e kompanive;

iii), një përfaqësues nga secila Organizatë e Shoqërisë Civile për grupin e Shoqërisë Civile.

4) Një Përfaqësi mund të kryejë zëvendësimin e anëtarëve të saj në çdo kohë. Përfaqësia informon Sekretariatën e EITI-t për Anëtarët e saj në çdo kohë.

5) Bordi i EITI-t mund të pezullojë funksionin e çdo Anëtari të Organizatës EITI, nëse:

i) Anëtari, ose vendi ose subjekti tjetër që Anëtari përfaqëson, nuk është në përputhje me këtë Statut; ose

ii) Anëtari, ose vendi ose subjekti tjetër që Anëtari përfaqëson, ka vepruar në dëm të apo në kundërshtim me Parimet EITI.

6) Rezoluta e Bordit të EITI-t në përputhje me Nenin 5 (5) mund të ankimohet nga çdo Anëtar në Mbledhjen e Anëtarëve për vendimin përfundimtar.

NENI 6 TARIFA E ANËTARËSIMIT

1) Nuk ka asnjë tarifë anëtarësimi për Anëtarët.

NENI 7 KONFERENCA EITI

1) Konferenca EITI mbahet të paktën çdo tre vjet dhe synon krijimin e një forumi ndërkombëtar për grupet e interesit për të çuar më tej objektivat e EITI-t dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre në lidhje me politikat dhe strategjitë e Organizatës EITI. Kryetari i EITI-t është njëherësh edhe kryetar i Konferencës. Konferenca EITI është një organ jo-drejtues i Organizatës EITI.

2) Anëtarët, Bordi dhe Sekretariati i EITI-t kanë të drejtë të marrin pjesë ose të përfaqësohen në Konferencën EITI. Mund të ftohen edhe palë të tjera të interesuara në atë masë që Bordi e gjykon të arsyeshme të veprohet në këtë mënyrë.

3) Konferenca EITI thirret nga Bordi i EITI-t, nëpërmjet publikimit në faqen e internetit dhe njoftimit me shkrim për Anëtarët dhe Përfaqësitë (Grupet) të paktën katër javë përpara. Njoftimi me shkrim duhet të përfshijë rendin e ditës së Konferencës EITI.

4) Konferenca EITI:

i) Siguron një platformë të rëndësishme dhe të dukshme për debat, përkrahje, mbledhje të vazhdueshme të fondeve, dhe përfshirjen e aktorëve të rinj;

ii) Rishikon progresin bazuar në raportin e veprimtarisë për periudhën nga koha e Mbledhjes së mëparshme të Anëtarëve;

iii) Ofron sugjerime për Bordin e EITI-t në kuadër të aktiviteteve të Organizatës EITI deri në mbledhjen e radhës të anëtarëve;

iv) Mobilizon dhe ruan koordinimin e nivelit të lartë, angazhimin dhe hovin politik për të arritur objektivin e Organizatës; dhe

v) Ofron një kanal komunikimi joformal për ato grupe interesi që nuk janë të përfaqësuara formalisht në struktura të tjera drejtuese të EITI-t.

5) Komentet lidhur me çështjet e përcaktuara në Nenin 7 (4) më sipër mund të shprehen në Deklaratën jo-të-detyrueshme të Rezultateve që miratohet në Konferencën EITI dhe që i komunikohet Mbledhjes së Anëtarëve dhe Bordit të EITI-t. Konferenca EITI bën të gjitha përpjekjet për të miratuar rezolutat me konsensus. Kryetari i EITI-t, duke marrë parasysh këndvështrimet e palëve të interesuara, mund të vendosë mbajtjen e një procesi votimi. Çdo aktor, përveç anëtarëve të Bordit dhe Sekretariatit, kanë të drejtën e një vote. Rezolutat e Konferencës EITI miratohen me shumicën e thjeshtë të atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë.

ENI 8 MBLEDHJA E ANËTARËVE

1) Organi drejtues i Organizatës EITI është Mbledhja e Anëtarëve.

2) Mbledhja e Anëtarëve përbëhet nga anëtarët e Organizatës EITI.

3) Mbledhja e zakonshme e anëtarëve mbahet të paktën çdo tre vjet në lidhje me Konferencën EITI. Mbledhja e zakonshme e Anëtarëve thirret nga Bordi i EITI-t përmes një njoftimi me shkrim të bërë të paktën katër javë përpara.

4) Mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret nga Bordi i EITI-t duke i njoftuar Anëtarët me shkrim të paktën tre javë përpara saj. Bordi i EITI-t siguron që Mbledhja e Jashtëzakonshme e Anëtarëve të mbahet brenda katër javësh pas marrjes nga Kryetari i EITI-t së kërkesës për organizimin e një mbledhje të tillë.

5) Anëtarët të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në Mbledhjen e Anëtarëve, duhet të njoftojnë Sekretariatit e EITI-t brenda datës së shprehur në njoftim. Një anëtar mund të përfaqësohet në Mbledhjen e Anëtarëve përmes një prokure me shkrim. Prokura mund të përfshijë udhëzime të veçanta në lidhje me votimin. Prokura duhet të nënshkruhet sipas rregullave dhe duhet të paraqitet në Sekretariat brenda datës së shprehur në njoftimin për mbledhje.

6) Kryetari i EITI-t vepron edhe si kryetar i Mbledhjes së Anëtarëve.

7) Kuorumi për organizimin e Mbledhjes së Anëtarëve kërkon minimalisht pjesëmarrjen e gjysmës së anëtarëve, dhe të paktën një të tretën e anëtarëve nga çdo grup Përfaqësues.

8) Mbledhja e Anëtarëve ndërmerr të gjitha përpjekjet për miratimin me konsensus të rezolutave. Në rast votimi, rezolutat miratohen me shumicë të cilësuar që kërkon mbështetjen e së paku dy të tretave të numrit të përgjithshëm të votave dhe mbështetjen e së paku një të tretës së anëtarëve

nga çdo grup përfaqësues. Numri i përgjithshëm i votave për anëtarët e çdo grupi është i barabartë dhe përcaktohet si vijon:

- i) Anëtarët nga grupi i Vendeve kanë secili të drejtën e një vote; dhe
- ii) votat e Anëtarëve të Kompanive dhe të Anëtarëve të Organizatave të Shoqërisë Civile përcaktohen duke pjesëtuar numrin total të votave të Vendit me numrin e Anëtarëve të Kompanive dhe Shoqërisë Civile respektivisht.
- iii) Kryetari i EITI-t shpall numrin e votave për secilin Anëtar të grupeve të ndryshme përfaqësuese para votimit.

NENI 9 FUNKSIONET E MBLEDHJES SË ANËTARËVE

1) Mbledhja Anëtarëve të EITI-t:

- i) Miraton raportin e aktiviteteve, pasqyrat financiare dhe planin e aktiviteteve të Bordit;
- ii) Zgjedh anëtarët dhe Zëvendësit për secilin Anëtar të Bordit EITI-t, pas propozimit nga Përfaqësitë përkatëse;
- iii) Zgjedh Kryetarin e EITI-t, me propozim të Bordit dhe,
- iv) Shqyrton çdo çështje tjetër sipas kërkesave të Anëtarëve. Këto kërkesa duhet të dorëzohen me shkrim tek Kryetari i EITI-t në kohën e duhur në mënyrë që këto çështje të përfshihen në rendin e ditës të përcaktuar në njoftimin e dhënë për Mbledhjen e Antarëve.

NENI 10 BORDI I EITI-t

1) Organi ekzekutiv i Organizatës EITI është Bordi, i zgjedhur nga dhe që vepron nën drejtimin e Mbledhjes së Anëtarëve.

2) Duke reflektuar natyrën shumë-palëshe të Organizatës EITI, Bordi përbëhet nga 20 Anëtarë (Anëtarë Bordi) dhe përbëhet si më poshtë:

- i) Një Kryetar;
- ii) 8 Anëtarë Bordi që janë Anëtarë të Organizatës EITI nga Përfaqësia e Vendeve, ku 3 anëtarë përfaqësojnë Vendet Mbështetëse ndërsa pjesa tjetër Vendet Zbatuese. Kur është e mundur, Vendet Zbatuese duhet të përfaqësohen nga të paktën 3 Vende Anëtare (në Përputhje).
- iii) 6 Anëtarë Bordi që janë Anëtarë të Organizatës EITI nga grupi i Kompanive, ku të paktën 1 duhet të përfaqësojë Investoret Institucionalë.
- iv) 5 anëtarë Bordi që janë Anëtarë të Organizatës EITI nga grupi i Organizatave të Shoqërisë Civile.

3) Mandati i anëtarëve të Bordit zgjat deri në përfundim të Mbledhjes tjetër të zakonshme të Anëtarëve, të mbajtur pas emërimit të tyre, por kanë të drejtë të ri-zgjidhen në këtë Mbledhje.

4) Grupet përfaqësuese mund të emërojnë, dhe Mbledhja e Anëtarëve mund të zgjedhë, një zëvendës Anëtar Bordi (një "Zëvendës") për secilin nga anëtarët e emëruar. Një Zëvendës mund të përfaqësojë një Anëtar Bordi. Nëse nuk ekziston një Zëvendës, Grupi përkatës emëron një Anëtar të ri të Bordit dhe Zëvendësin e tij.

5) Në qoftë se një Anëtar mungon në Mbledhjen e Bordit, Zëvendësi i atij anëtari mund të marrë pjesë në mbledhje, në diskutime, të votojë dhe në përgjithësi të kryejë të gjitha funksionet e Anëtarit në mbledhjen e Bordit.

6) Në rast se ekziston një vend vakant në Bordin e EITI-t midis dy Mbledhjeve të Anëtarëve, ky vend plotësohet me Zëvendësin e Anëtarit të dorëhequr të Bordit, ku grupi përkatës emëron një Zëvendës të ri që do të zgjidhet në Bord. Në rast të kundërt, grupi përkatës mund të emërojë një Anëtar të ri Bordi.

7) Organizata EITI merr sigurimin ndaj detyrimeve për anëtarët e Bordit. Termat dhe kushtet miratohen nga Bordi i EITI-t.

8) Bordi mund të vendosë që një anëtar Bordi që përfaqëson një vend zbatues të pezulluar gjatë kohës së mandatit të mbajë statusin si Anëtar Bordi, por duke u përjashtuar nga aktivitetet e Bordit gjatë periudhës së pezullimit. Nëse pezullimi mbetet në fuqi për më shumë se një vit, Bordi i EITI-t mund të vendosë t'i japë fund anëtarësimit në Bord.

NENI 11 VËZHGUESIT

1) Përfaqësues nga organizata të rëndësishme ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe palët e tjera të interesuara, duhet të ftohen nga Bordi i EITI-t për të marrë pjesë në Mbledhjet e Bordit dhe Mbledhjet e Anëtarëve si vëzhgues, në rast se kjo gjë është konkretisht e mundur. Ata nuk kanë të drejtë vote, por mund të shprehin pikëpamjet e tyre mbi çështje të caktuara. Bordi i EITI-t mund të vendosë që disa çështje të caktuara të diskutohen pa praninë e vëzhguesve.

NENI 12 KRYETARI I EITI-t

1) Kryetari i EITI-t zgjidhet në Mbledhjen e zakonshme të Anëtarëve të EITI-t. Bordi i EITI-t, para Mbledhjes së zakonshme të Anëtarëve, sugjeron një kandidat për Kryetar të EITI-t për periudhën pas Mbledhjes së Antarëve. Kryetari i EITI-t ka të drejtën të ri-zgjidhet vetëm një herë.

2) Kryetari i EITI-t:

- i) Vepron si kryetar i Mbledhjes së Antarëve;
- ii) Vepron si kryetar i mbledhjes së Bordit të EITI-t;
- iii) Paraqet raportin e Bordit në Konferencën dhe Mbledhjen e Anëtarëve të EITI-t;
- iv) Përfaqëson Bordin e EITI-t në çështjet e jashtme;
- v) Ndjek së bashku me Sekretariatit EITI zbatimin e rezolutave të Bordit; dhe
- vi) Përpiqet të nxisë marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të EITI-t.

3) Nëse Kryetari i EITI-t nuk është në gjendje të drejtojë Mbledhjen e Bordit, Bordi i Anëtarëve të pranishëm mund të emërojë një tjetër Anëtar Bordit për drejtimin e mbledhjes.

NENI 13 FUNKSIONET E BORDIT TË EITI-t

1) Bordi i EITI-t vepron në çdo kohë në interesin më të mirë të Organizatës EITI. Bordi ushtron pushtetin ekzekutiv të Organizatës sipas rezolutave të Mbledhjes së Antarëve, përfshirë edhe funksionet e mëposhtme kryesore:

- i) Analizon çështjet e përgjithshme dhe specifike të politikave që prekin Organizatën EITI,
- ii) Bie dakord mbi planet e punës dhe buxhetin e Organizatës EITI;
- iii) Bie dakord mbi masat organizative për Konferencat e EITI-t dhe Mbledhjet e Anëtarëve;
- iv) Paraqet (nëpërmjet Kryetarit të EITI-t) raportin e veprimtarisë dhe planin e aktiviteteve në Konferencën e EITI-t dhe merr miratimin e tyre në Mbledhjen e Anëtarëve;
- v) Paraqet (nëpërmjet Kryetarit të EITI-t) pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e auditimit për periudhat kontabël që prej Mbledhjes së fundit të zakonshme të Anëtarëve të EITI-t;
- vi) Angazhon Drejtuesin e Sekretariatit;
- vii) Mbikëqyr dhe drejton (nëpërmjet Kryetarit të EITI-t) punën e Sekretariatit;
- viii) Siguron që natyra shumë-palëshe e EITI-t të ruhet dhe të pasqyrohet plotësisht në Organizatën EITI në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe komisionet e tij;
- ix) Krijon procedurat lidhur me procesin e validimit, përfshirë ankesat, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, çështjen e ç'regjistrimit të një vendi dhe procedurat e ankimimit;
- x) Adopton procedura dhe rregulla më të detajuara për menaxhimin dhe funksionimin e Organizatës duke përfshirë edhe përmbajtjen e planeve të punës për vendet dhe planeve të punës të kompanive, procesin e validimit, menaxhimin e fondeve, pagesat për projekte, mallra dhe shërbimeve, auditimin dhe raportimin si dhe miratimin e projekteve;
- xi) Rekomandon kandidatin për Kryetar të EITI-t para çdo mbledhjeje të zakonshme të Anëtarëve të EITI-t; dhe
- xii) Miraton kodin e sjelljes.

NENI 14 KOMITETET E BORDIT TË EITI-t

1) Bordi i EITI-t mund të krijojë komitete për çështje më specifike. Çdo komitet i tillë duhet të përfshijë dy ose më shumë Anëtarë Bordi apo Zëvendësit e tyre, dhe përbërja e tij duhet, për aq sa është e arsyeshme, të reflektojë natyrën shumë-palëshe të EITI-t. Kushtet në të cilat çdo komision i tillë do të veprojë duhet të regjistrohen në Proces-Verbalin e mbledhjes.

NENI 15 OPERACIONET DHE PROCEDURAT E BORDIT TË EITI-t

1) Bordi duhet të mblidhet së paku dy herë në vit. Nëse rrethanat e kërkojnë, Mbledhjet e Bordit të EITI-t mund të mbahen përmes tele-konferencave (me telefon). Të paktën një Mbledhje në vit e Bordit të EITI-t duhet të kryhet me pjesmarrjen fizike të anëtarëve.

2) Mbledhja e Bordit thirret nëpërmjet njoftimit me shkrim nga Kryetari i EITI-t të paktën 14 ditë përpara. Çdo njoftim më i shkurtër kërkon pëlqimin me shkrim të të gjithë anëtarëve të Bordit.

3) Anëtarët e Bordit bëjnë të gjitha përpjekjet për të miratuar rezolutat me konsensus. Kryetari i EITI-t, duke marrë parasysh këndvështrimet e palëve të interesuara, mund të vendosë mbajtjen e një procesi votimi. Çdo anëtar i Bordit të EITI-t ka të drejtën e një vote. Votimi mund të bëhet edhe përmes një prokure me shkrim.

4) Asnjë resolute nuk mund të miratohet në një mbledhje të bordit nëse në kohën e kalimit të rezolutës nuk është i pranishëm kuorumi i nevojshëm. Kuorumi krijohet me të paktën dy të tretat e Anëtarëve të Bordit nga Përfaqësuesit e Vendeve (një Vend Zbatues dhe një Vend Mbështetës), një anëtar Bordi nga Përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile dhe një Anëtar Bordi nga Përfaqësuesit e Kompanive.

5) Në qoftë se kërkohet votim, rezolutat miratohen me shumicë të cilësuar që kërkon 13 vota në favor të rezolutës, dhe duhet të përfshijë mbështetjen e të paktën një të tretës së votave të anëtarëve të Bordit nga çdo grup përfaqësues.

6) Një anëtar Bordi nuk lejohet të votojë në lidhje me çështje apo marrëveshje në të cilën ai ose ajo ka interes të drejtpërdrejtë, ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera të veçanta të cilat mund të dëmtojnë besimin në paanshmërinë tij ose të saj. Një anëtar Bordi duhet t'i paraqesë këto interesa me shkrim në Bordin e EITI-t, sapo ai ose ajo bëhet i vetëdijshëm për një gjë të tillë. Një anëtar Bordi nuk do të llogaritet në kuorumin e pranishëm kur rezoluta ka lidhje me një çështje për të cilën anëtari i Bordit nuk ka të drejtë të votojë.

7) Bordi i EITI-t mund të përcaktojë procedura lidhur me proceset e vendim-marrjes jashtë mbledhjeve të Bordit. Të gjitha vendimet që merren jashtë mbledhjeve të Bordit në përputhje me këto procedura duhet të regjistrohen në Procesverbalin e mbledhjes së Bordit pas marrjes së tyre.

8) EITI mund të angazhohet nga jashtë me nënshkrimin e përbashkët të të gjithë anëtarëve të Bordit. Bordi i EITI-t mund të zgjedhë vetëm Kryetarin, ose dy ose disa anëtarë të Bordit për të pasur të drejtën e nënshkrimit, të cilat mund të nënshkruhen së bashku.

NENI 16 SEKRETARIATI EITI

1) Sekretariati i EITI-t ("Sekretariati") përbëhet nga Shefi i Sekretariatit dhe personeli tjetër i nevojshëm. Anëtarët e Sekretariatit kontraktohen drejtpërdrejt ose delegohen nga Anëtarët e EITI-t.

2) Sekretariati është përgjegjës për drejtimin e përditshëm të EITI-t nën drejtimin e Bordit nëpërmjet Kryetarit.

3) Sekretariati mban një Regjistër të përditësuar të Anëtarëve gjatë gjithë kohës.

4) Sekretariati mban një kopje të Statutit të Shoqatës dhe ndryshimeve në të.

5) Sekretariati mban procesverbalet e të gjitha Mbledhjeve të Bordit, Mbledhjeve të Anëtarëve dhe mbledhjet e Konferencës së EITI-t, në Blllokun e Procesverbalit. Të gjitha këto procesverbale publikohen në faqen e internetit të EITI-t. Procesverbalet regjistrojnë emrat e të pranishmëve, rezolutat e bëra në takime dhe, sipas rastit, arsyet për rezolutat.

NENI 17 DREJTUESI I SEKRETARIATIT EITI

1) Sekretariati drejtohet nga Drejtuesi i Sekretariatit që është i punësuar me kohë të plotë dhe i cili menaxhon administrimin e përditshëm të Shoqatës EITI, përfshirë zgjedhjen e stafit të nevojshëm, mbikëqyrjen e zhvillimit të EITI-t dhe siguron mbështetjen e Bordit. Drejtuesi i Sekretariatit i raporton Bordit të EITI-t nëpërmjet Kryetarit dhe është përgjegjës për aktivitetet e Sekretariatit.

2) Drejtuesi i Sekretariatit, ose i emëruari i tij nga Sekretariati, vepron si Sekretar në të gjitha mbledhjet e Bordit, Mbledhjet e Anëtarëve dhe Konferencat e EITI-t.

NENI 18 FINANCIMI

1) EITI është një organizatë jo-fitimprurëse. Fondet e tij përbëhen nga kontributet vullnetare të anëtarëve të saj dhe grantet nga donatorët dypalësh dhe shumëpalësh, institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjenci, organizma dhe subjekte të tjera.

2) EITI mund të punojë edhe përmes kontributeve vullnetare me natyrë të ngjashme.

NENI 19 LLOGARITË, MENAXHIMI I FONDEVE DHE PAGESAT E EITI-t

1) EITI mban një llogari bankare të veçantë në emër të tij, e quajtur “Llogaria e Menaxhimit Ndërkombëtar të EITI – EITI International Management Account”. Llogaria e Menaxhimit Ndërkombëtar të EITI-t mund të përdoret për çdo lloj aktiviteti që është në përputhje me objektivat e organizatës dhe planet e punës të miratuara nga Bordi i EITI-t. Fondet mund të përdoren për shpenzime administrative dhe të drejtimit, aktivitetet për vende të veçanta apo për shumë vende.

2) Bordi i EITI-t emëron një auditor të jashtëm, të pavarur i cili ka për detyrë të kryejë çdo vit auditimin e Llogarisë Ndërkombëtare të EITI-t, dhe t’i paraqesë me shkrim Bordit të EITI-t një raport auditimi. Bordi i EITI-t harton rregullat e raportimit dhe auditimit në lidhje me Llogarinë e Menaxhimit Ndërkombëtar të EITI-t, të cilat i shtohen rregullave plotësuese operative dhe procedurave të Organizatës EITI.

NENI 20 AMENDIMET

1) Këto përcaktime të Statutit mund të ndryshohen në Mbledhjen e Anëtarëve të EITI-t, që thirret dhe mbahet sipas Nenit 8, me miratimin e të paktën dy të tretave të Anëtarëve të pranishëm. Propozimi për ndryshime i komunikohet me shkrim të gjithë Anëtarëve të EITI-t katër javë përpara rezolutës përkatëse.

NENI 21 RISHIKIMI

1) Rishikimi i rregullave të drejtimit të EITI-t ndërmerret nga Bordi i EITI-t brenda dy viteve nga themelimi i tij.

NENI 22 TËRHEQJA DHE SHPËRBËRJA

1) Çdo anëtar mund të tërhiqet nga Organizata EITI në çdo kohë. Tërheqja hyn në fuqi pas marrjes së njoftimit me shkrim të tërheqjes nga Shefi i Sekretariatit.

2) EITI mund të shpërbëhet me vendim të Mbledhjes së Anëtarëve, në përputhje me dispozitat e Nenit 8. Propozimi për shpërbërje i komunikohet me shkrim të gjithë Anëtarëve të EITI-t katër javë përpara rezolutës përkatëse.

3) Në rast të shpërbërjes, asetet e Organizatës përdoren për objektiva të ngjashme me ato të Organizatës EITI dhe sipas përcaktimeve të Bordit të EITI-t janë objekt miratimi nga Mbledhja e Antarëve.

NENI 23 HYRJA NE FUQI

1) Statuti hyn në fuqi, pas themelimit të Organizatës EITI.

ANEKS A: Parimet e EITI-t. Sipas përcaktimeve në Nenin 1 të këtij publikimi.

ANEKS B : Përdorimi i emrit dhe logos së EITI-t janë pronë e EITI-t. Si rregull i përgjithshëm, inkurajohet dhe lejohet përdorimi i emrit EITI, pra EITI ose Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, dhe logos apo derivateve lokale në materiale ose përkthime, sipas kufizimeve të specifikura në <http://www.eiti.org/about/logopolicy>.

6 Politika e Transparencës.

1. Dokumentet e EITI janë publike, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe si më poshtë.

2. Dokumentet e paraqitura në EITI për çështje operationale dhe/ose biznesi, të cilat për **arsye konkurrence** është e rëndësishme të mbahen sekret në interes të personit të cilit i përket informacioni, nuk janë të aksesueshme.

Për shembull, një sekret biznesi zakonisht përjashtohet nëse bërja publike e tij ka mundësi të influencojë pozicionin konkurrues të kompanisë në fjalë.

3. Dokumentet që përmbajnë informacion të marrë nga një palë e tretë nuk janë të aksesueshëm në rast se publikimi i tij ka gjasa të prekë interesat legjitime të asaj pale.

Për shembull, nuk lejohet akses në dokumente në rastet kur rrezikohet siguria personale e palës së tretë dhe/ose familjes së tij dhe/ose e çdo personi të lidhur ngushtë me palën në fjalë. Për më tepër, mbrojtja e privatësisë personale cilësohet si interes legjitim e për rrjedhojë përjashtohet .

4. Nuk lejohet akses në **dokumente të brendshme të punës** së EITI.

Për shembull, dokumentet që Sekretariati Ndërkombëtar i dërgon Bordit të EITI-t dhe komisioneve të tij zakonisht konsiderohen dokumente të brendshme duke u përjashtuar në këtë mënyrë nga publikimi. Ky përjashtim vlen kur Sekretariatit Ndërkombëtar, gjatë përgatitjes së

një çështje që do t'i paraqitet Bordit të EITI-t, ka përgatitur apo porositur një analizë apo raport nga një burim i jashtëm. Në dallim nga kjo, procesverbalet përfundimtare të mbledhjeve të Bordit të EITI, si dhe të komisioneve dhe grupeve të punës nuk konsiderohen dokumente të brendshme. Normalisht, komunikimet elektronike (e-mailet) ndërmjet kolegëve konsiderohen dokumente të brendshme të punës.

5. Përjashtohet aksesimi në të dhënat **personale** të personelit të EITI.

Për shembull, përjashtohet aksesimi në dokumentet e vlerësimeve të bëra në lidhje me rekrutimin, shkarkimin, dhe/ose performancën e personelit si dhe të dhënat personale në lidhje me shëndetin e anëtarëve të personelit. Nga ana tjetër, janë publike të gjitha kontratat, pagat, shpërblimet dhe kontabiliteti i shpenzimeve.

7 Projekt-Udhëzimet e Përfaqësimit në EITI

Sekretariati Ndërkombëtar EITI, 26 Prill 2013

Historiku

Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Këshillimit, miratuar në Konferencën e Oslos në Tetor 2006 miratoi krijimin në Oslo të një Bordi prej 20 vetash që shërben deri në Konferencën e ardhshme EITI. Bordi përbëhet nga:

- Kryetari;
- Përfaqësues të vendeve zbatuese;
- Përfaqësues të donatorëve;
- Përfaqësues të OJQ-ve;
- Kompanite;
- Një investitor.

Të gjithë, përveç kryetarit, kanë të drejtë të kenë një zëvendës. Është rënë dakord që secila prej përfaqësive të përcaktojë mënyrën e zgjedhjes së të emëruarve të saj.

Gjatë Mbledhjes së Anëtarëve në Doha në Shkurt 2009 u shqyrtua propozimi për regjistrimin ligjor të Bordit dhe Sekretariatit EITI. Propozimi u mbështet gjerësisht në raportin e Grupit Ndërkombëtar të Këshillimit. U sugjerua që grupet e ndryshme të interesit të përfaqësohen në të njëjtën mënyrë siç ndodh aktualisht.

Sipas Raportit të GNK-së "Secili prej grupeve përfaqësuese duhet të bjerë dakord për mënyrën e përfaqësimit në Bordin e propozuar. Kjo kërkon shqyrtim paraprak nga ana e çdo grupi

përfaqësues sesi ata i përkufizojnë personat e përshtatshëm (i) për t'u zgjedhur si përfaqësues; dhe (ii) për t'u përfshirë në procesin e përzgjedhjes.

Udhëzimet

Duke pasur parasysh parimin e rëndësishëm që grupet e ndryshme përfaqësuese në EITI kanë të drejtë të përcaktojnë proceset e tyre të brendshme, ky dokument ofron disa udhëzime mbi këto procese.

Grupet përfaqësuese janë përcaktuar në Statutin e Organizatës, i cili përcakton edhe numrin e anëtarëve të grupeve përfaqësuese në Organizatë dhe numrin e vendeve në Bordin e EITI-t. (Shumë prej frymëzimit dhe gjuhës së përdorur në këto udhëzime është marrë nga udhëzimet e Fondit Global për Luftën kundër Sidë-s, Tuberkulozit dhe Malaries për proceset e përfaqësimit.) Disa nga grupet përfaqësuese në EITI, në mënyrë të veçantë, përfaqësitë e kompanive, ndahen në mënyrë joformale në nën-grupe. Aktualisht, kompanitë minerare organizohen në mënyrë të pavarur nga kompanitë e naftës dhe gazit. Proceset e aplikuara nga këto nën-grupe mbështeten në parimet e mëposhtme:

- Proceset e ndjekura nga përfaqësitë e ndryshme duhet të jenë të hapura dhe transparente
- Informacioni në lidhje me këto procese duhet të publikohet në faqen e internetit të EITI-t, përfshirë personin e kontaktit për çdo palë të interesuar që dëshiron të përfshihet.
- Procesi duhet të jetë fleksibël dhe i hapur për anëtarët e rinj. Grupet përfaqësuese duhet të mbajnë parasysh domosdoshmërinë për të balancuar nevojën për vazhdimësi kundrejt nevojës për rinovim dhe zgjerim të pronësisë së EITI-t.
- Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që Bordi ka për EITI, vendet dhe organizatat inkurajohen që të përfaqësohen në të ne nivel te larte.

Është e nevojshme që grupet përfaqësuese të ndërjegjësohen rreth rëndësisë së përfaqësimit të të gjitha palëve të interesuara në Bordin dhe Organizatën EITI. Për shembull, pritet që vendet nga rajone të ndryshme, kompanitë dhe organizatat e shoqërisë civile të lidhura ngushtë me rajone të ndryshme, të jenë të përfaqësuara në këto organizma. Megjithëse mund të jetë e vështirë të përcaktohet një ekuilibër gjinor në një organ ndërkombëtar të tillë si Bordi i EITI-t, grupet përfaqësuese inkurajohen të sigurojnë përfaqësim adekuat të të dyja gjinive.

Në mënyrë të veçantë, për grupet e ndryshme përfaqësuese.

Vendet

Organizata e Vendeve Anëtare të EITI

Të gjitha vendet zbatuese dhe ato mbështetëse kanë të drejtë të bëhen anëtarë të Organizatës.

Bordi EITI

- Vendet Zbatuese: Anëtarët e Bordit mund të zgjidhen nga qeveritë e atyre vendeve të cilat janë duke 'zbatuar nismën në mënyrë të dukshme', pra ftohen përfaqësues nga ato vende që kanë paraqitur të paktën një Raport EITI brenda dymbëdhjetë muajve të fundit (kjo frazë është marrë nga procesverbalet e mbledhjes së 5-të të GNK-së). Përfaqësimi duhet të reflektojë sa më shumë që të jetë e mundur një shpërndarje gjeografike dhe sektoriale. Krijimi i një sistemi të nën-grupeve përfaqësuese siguron përfshirjen e të gjitha pikëpamjeve të vendeve zbatuese.
- Vendet mbështetëse: Anëtarët e Bordit duhet të zgjidhen nga qeveria e atyre vendeve që kanë dhënë mbështetje të dukshme financiare, politike, apo teknike për zbatimin e EITI-t. Vendet mbështetëse duhet të marrin në konsideratë krijimin e një nën-grupi përfaqësues i cili do të rrisë angazhimin e vendeve të tjera mbështetëse ndërkohë që ato i bashkohen familjes EITI. Pritet që disa vende në zhvillim t'i bashkohen grupit gjatë dy viteve të ardhshme.

Organizatat e Shoqërisë Civile në Organizatën e Anëtarëve EITI

Organizata e Vendeve Anëtare të EITI

Të gjitha organizatat e shoqërisë civile kanë të drejtë të bëhen anëtarë të Organizatës.

Bordi EITI

Anëtarët e **Bordit EITI** duhet të zgjidhen ndërmjet atyre që e kanë mbështetur në mënyrë aktive zbatimin e nismës - goftë në nivel ndërkombëtar apo kombëtar.

'Koalicioni Publikoni Atë Që Paguani' ka kryer konsultim me anëtarët e tyre për mënyrën sesi do të menaxhohet përzgjedhja e këtij grupi përfaqësues. Përfaqësuesit e shoqërië civile të interesuar për t'u përfaqësuar në Organizatën ose Bordi e EITI-t inkurajohen të kontaktojnë Koalicionin 'Publikoni Atë Që Paguani'.

Kompanitë

Organizata e Vendeve Anëtare të EITI

Të gjitha kompanitë që mbështesin EITI-n dhe pesë investitorë institucionalë kanë të drejtë të bëhen anëtarë të Organizatës.

Bordi EITI

Ekzistojnë katër kategori të mëdha të kompanive të përfaqësuara në grupin e përfaqësimit të kompanive: kompanitë e naftës dhe gazit, kompanitë minerare, ndërmarrjet shtetërore dhe investitorët institucionalë.

Kompanitë dhe investitorët inkurajohen të komunikojnë me njëri-tjetrin për të rënë dakord mbi përfaqësimin në Organizatë dhe për emërimin e Bordit të ardhshëm. Sekretariati mbetet në dispozicion për të lehtësuar të gjitha proceset e emërimit.

Ankesat

Nëse një nga palët e interesuara të EITI-t dëshiron të ankohet rreth proceseve të ndjekura nga grupi i tij përfaqësues për miratimin e përfaqësuesve të tij në Organizatën ose Bordin e EITI-t, këto ankesa duhet t'i drejtohen së pari anëtarëve të grupit përkatës. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje e kënaqshme, atëherë përpilohet një raport i shkruar i cili i dërgohet Sekretariatit Ndërkombëtar të EITI-t. Sekretariati shqyrton ankesën brenda tre javëve nga marrja e saj dhe përgatit një raport mbi gjetjet e tij i cili paraqitet në Bordin e EITI-t.

Standarti EITI (Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse) është një standart ndërkombëtar që synon të sigurojë transparencën e të ardhurave nga nafta, gazi dhe burimet minerare. Ai është ndërmarrë dhe mbikqyret nga një koalicion i qeverive, kompanive, shoqërisë civile, investitorëve dhe organizmave ndërkombëtare. Të gjitha këto grupe përfaqësohen në Bordin e EITI-t i cili mbështetet nga Sekretariati Ndërkombëtar. Standarti EITI ka një metodologji sa të fuqishme aq dhe fleksibël, e cila adoptohet nga vendet për të trajtuar çështjet specifike me të cilat përballen. Pas zbatimit, EITI siguron më shumë transparencë në mënyrën e menaxhimit të burimeve natyrore të një vendi, dhe deklarin e plotë të të ardhurave të qeverisë nga sektorët e industrisë nxjerrëse.